

*Bashkëpunim Shkencor në Mbështetje të Peshkimit të
Përgjegjshëm në
Detin Adriatik*

**Kodi I Drejtimit
Per
Peshkim Të Përgjegjshëm**

Referenca bibliografike:

Adriamed (Botim). 2000. Përkthim në shqip i Kodit të Fao-s të Drejtimit për një Peshkim të Përgjegjshëm. GCP/RER/010/ITA/AT-01 40f.

*Originali: Kodi i Drejtimit për një Peshkim të Përgjegjshëm
Organizata e Kombeve Të Bashkuar Për Ushqimin Dhe Bujqësinë, UN, Romë, 1995*

Specifikimet e përdorura dhe paraqitja e materialit në këtë botim nuk nënkuptojnë absolutisht shprehjen e opinionëve nga ana e Organizatës së Bujqësisë dhe Ushqimit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me statusin legal të vendeve, territoreve, qyteteve, zonave dhe të autoriteteve të tyre, ose në lidhje me përcaktimin e kufive të tyre.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të depozitohet në sistemet e informacionit, të transmetohet me çfarëdo forme o mjeti, si elektronike, mekanike , fotokopjimi ose të tjera, pa lejen e duhur të autorit. Kërkesa për këtë leje, që duhet të përmbajë qëllimin dhe madhësinë e riprodhimit, duhet të drejtohet: Director, Publications Divisions, Food and Agriculture Organization of the United Nations, Viale delle Terme di Caracalla, 00100 Rome, Italy.

Presentation

“Fisheries, including aquaculture, provide a vital source of food, employment, recreation, trade and economic well-being for people throughout the world, both for present and future generations and should therefore be conducted in a responsible manner”. *The Code of Conduct for Responsible Fisheries, adopted by the Twenty-eight Session of the FAO Conference on 31 October 1995, represents an informative and contemporary tool for countries to use when addressing their policies on fishery and aquaculture management.*

Ever since its adoption, FAO has been developing activities to promote large scale application of the Code. In order to encourage the its implementation, FAO has produced and disseminated numerous translations of the Code. A series of Technical Guidelines for Responsible Fisheries have also been published by the FAO Fisheries Department as support for the application of the Code (<http://www.fao.org/fi/agreem/codecond/codecon.asp>). Several projects are currently underway, workshops and meetings concerning the Code have taken place and more are planned for the future. Activities focusing on the Code concerning research, industries, information and policy have also been developed.

In accordance with the Code of Conduct for Responsible Fisheries, in the presence of fishery resources exploited by more than one country and the problems inherent in this situation, the introduction and implementation of cooperative resources management is a fundamental objective. Regional projects in which all the countries concerned participate are strongly recommended. The Adriamed Project, “*Scientific Cooperation to Support Responsible Fisheries in the Adriatic Sea*”, was born to support Adriatic countries in the implementation of management strategies which promote responsible fisheries. The Adriatic is a sea where the presence of shared stocks necessitates common management practices.

Adriamed is a regional project with scientific cooperation as its priority and is based on support for cooperative management of the Adriatic basin. The project aims are: establishing a common pool of knowledge related to the management of the Adriatic Sea fisheries; strengthening technical co-ordination among national research institutes and administrations and between them and stakeholder organisations of participating countries; supporting and assisting the implementation, at basin level, of the principles of the Code.

Within the context of the propagation of the Code, the Adriamed Project is organising its translation and dissemination in the regional languages. The Republic of Albania is one of the countries adhering to the Code and the present document represents the Albanian language version.

<p>This publication was originally published by the Food and Agriculture Organization of the United Nations (FAO) in 1995. This Albanian translation has been prepared on behalf of the Adriamed Project and FAO accepts no responsibility therefor</p>

Prezantimi

“Peshkimi, duke përfshire dhe akuakulturën, siguron një burim jetësor ushqim, punësimi, rikrijimi, tregëtimi dhe mirëqenie ekonomike për njerezit në gjithë botën, për brezat e tanishëm dhe brezat e ardhshëm, prandaj duhet të drejtohet në një mënyrë të përgjegjshme”. Kodi i Drejtimit për Peshkim të Përgjegjshëm, miratuar në Sesionin e 28-te të Konferencës së FAO-s me 31 Tetor 1995, përfaqson për shtetet një mjet informativ dhe bashkëkohor për tu përdorur në përgatitjen e politikave të tyre në drejtim të menaxhimit të peshkimit dhe akuakultures.

Që nga miratimi i tij, FAO ka zhvilluar aktivitete për të nxitur në shkallë të gjërë zbatimin e Kodit. Me qëllim që të inkurajojë zbatimin e tij, FAO ka realizuar dhe publikuar shumë përkthime të Kodit. Gjithashtu një numër Udhëzuesish Teknike për Peshkim të Përgjegjshëm janë botuar nga Departamenti i Peshkimit i FAO-s si mbështetje për zbatimin e Kodit (<http://www.fao.org/fi/agreem/codecond/codecon.asp>). Projekte të ndryshme që janë aktualisht në zbatim, kanë zhvilluar seminare dhe takime në lidhje me Kodin dhe kanë planifikuar më shumë në të ardhmen të tilla aktivitete. Gjithashtu janë zhvilluar aktivitete kryesore të Kodit në lidhje me kërkimin shkencor, industrinë, informacionin dhe politikën.

Në përputhje me Kodin e Drejtimit për Peshkim të Përgjegjshëm, në prezencë të resurseve peshkore të shfrytëzuara nga më shumë se një shtet dhe problemeve karakteristike në këtë situatë, paraqitja dhe zbatimi menaxhimit kooperues të resurseve është objektivi themelor. Kjo është fortësisht rekomanduar për projektet rajonale, në të cilat marrin pjesë të gjitha shtetet e përfshira në situatën e lartpërmendur. Projekti Adriamed, “Bashkëpunim Shkencor në Mbështetje të Peshkimit të Përgjegjshëm në Detin Adriatik”, është krijuar për të mbështetur vendet e Adriatikut në zbatimin e strategjive të menaxhimit për nxitjen e peshkimit të përgjegjshëm. Deti Adriatik është deti ku prezenca e rezervave peshkore të përbashkëta (shared stocks) kërkon praktika të përbashkëta menaxhuese.

Adriamed është një projekt rajonal ku prioritetet e tij është bashkëpunimi shkencor dhe është bazuar në mbështetjen për menaxhim kooperues në detin Adriatik. Qellimet e projektit janë: krijimi i një grupimi të përbashkët të njohurive në lidhje me menaxhimin e peshkimit në detin Adriatik; forcimi i koordinimit teknik ndërmjet instituteve të kërkimeve shkencore të peshkimit dhe administratave, dhe ndërmjet tyre dhe organizmave të punonjësve të peshkimit të shteteve bregdetare; mbështetja dhe asistenca ndaj vendeve të Adriatikut në zbatimin e parimeve të Kodit.

Brënda kontekstit të publikimit të Kodi i Drejtimit për Peshkim të Përgjegjshëm, Projekti Adriamed është duke organizuar përkthimin dhe shpërndarjen e tij në gjuhët e rajonit. Republika e Shqipërisë është një nga vendet e aderuar të Kodit dhe dokumenti i prezantuar paraqet Kodin e Drejtimit për Peshkim të Përgjegjshëm në gjuhën shqipe.

PERMBAJTJA

PARATHËNIA	vii
HYRJA	1
Neni 1 - Natyra dhe Qëllimi i Kodit	1
Neni 2 - Objektivat e Kodit	1
Neni 3 - Marrëdhënjet me Dokumentat e tjerë Nderkombëtarë	2
Neni 4 - Zbatimi, Monitorimi dhe Agjiornimi	3
Neni 5 - Nevoja të veçanta të Vendeve në Zhvillim	3
Neni 6 - Parimet e Pergjithshme	4
Neni 7 - Menaxhimi i Peshkimit	6
Neni 8 - Aktivitetet e Peshkimit	13
Neni 9 - Zhvillimi i Akuakultures	20
Neni 10 - Integrimi i Peshkimit në Manexhimin e Zonës Bregdetare	22
Neni 11 - Aktivitetet Pas-zenjes së Peshkut dhe Tregetia	24
Neni 12 - Kerkimet Shkencore në Peshkim	27
 Aneksi 1 PERMBLEDHJE RRETH ORIGJINËS DHE PERPUNIMIT TE KODIT	30
 Aneksi 2 REZOLUTË	34

HYRJA

Peshkimi, duke përfshire dhe akuakulturën, siguron një burim jetësor ushqimi, punësimi, rikrijimi, tregëtimi dhe mirëqenie ekonomike për njerezit në gjithë botën, për brezat e tanishëm dhe brezat e ardhshëm, prandaj duhet të drejtohet në një mënyrë të përgjegjeshme. Ky kod paraqet parimet dhe standartet ndërkombëtare të drejtimit për praktika të përgjegjeshme, me qëllim të sigurojë një ruajtje, menaxhim dhe zhvillim efektiv e resurseve ujore të gjalla, me respektin e duhur për ekosistemin dhe biodiversitetin. Kodi pranon rëndësinë ushqimore, ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe kulturele të peshkimit dhe interesat e të gjithë atyre që kanë lidhje me sektorin e peshkimit. Kodi merr parasysh karakteristikat biologjike të resurseve dhe mjedisin e tyre, interesat e konsumatorëve dhe përdoruesve të tjerë. Shtetet dhe të gjithë ata që punojnë e kanë lidhje me sektorin e peshkimit ftohen të zbatojnë Kodin, duke e bërë atë efektiv.

NENI 1 - NATYRA DHE QËLLIMI I KODIT

1.1 Kodi është vullnetar. Megjithatë, disa pjesë të tij janë bazuar në rregullat përkatëse të ligjit ndërkombëtar, duke përfshirë ato të formuluar në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Detit (United Nations Convention on the Law of the Sea) të 10 Dhjetorit 1982. Kodi gjithashtu përmban klauzola që mund të hyjnë ose tashmë kanë hyrë në fuqi nëpërmjet dokumentave të tjerë legal detyruese ndërmjet Palëve, sic është Marrëveshja për Nxitjen e Respektimit të Masave Ndërkombëtare në Ruajtjen dhe Manexhimin nga Anijet e Peshkimit në Det të Hapur (Agreement to Promote Compliance with International Conservation and Management Measures by Fishing Vessels on the High Seas), 1993, e cila në përputhje me rezolutën e Konferencës së FAO-s 15/93, paragrafi 3, formon një pjesë integrale të Kodit.

1.2 Kodi është global në qëllim, dhe është drejtuar anëtarëve dhe jo-anëtarëve të FAO-s, enteve të peshkimit, organizmave, qeveritare dhe joqeveritare, që operojnë në aktivitete të peshkimit në nivel nën-rajonale, rajonale dhe globale, dhe gjithë personave, që janë të interesuar në ruajtjen e resurseve peshkore, në manexhimin dhe zhvillimin e peshkimit, siç janë peshkatarët, dhe atyre të angazhuar në përpunimin dhe marketingun e peshkut dhe produkteve të peshkut, dhe përdoruesve të tjerë të mjedisit ujor në lidhje me peshkimin.

1.3 Kodi përcakton parime dhe standarte të zbatueshme për ruajtjen, menaxhimin dhe zhvillimin e të gjithë peshkimit. Ai gjithashtu mbulon zënjet, përpunimin dhe tregëtimin e peshkut dhe produkteve të peshkimit, aktivitetet e peshkimit, akuakulturën, kërkimin shkencor të peshkimit dhe integrimin e peshkimit në menaxhimin e zonës bregdetare.

1.4 Në këtë Kod, në referim të Shteteve përfshin Komunitetin Europian në çështjet brënda kompetencës së tij, dhe termi peshkim është aplikuar në mënyrë të njëjtë për zënjen e peshkut dhe akuakulturën.

NENI 2 - OBJEKTIVAT E KODIT

Objektivat e Kodit të Drejtimit për Peshkim të Përgjegjeshëm janë të:

- a) përcaktojë parimet, në përputhje me rregullat përkatëse të ligjeve ndërkombëtare, për aktivitetet e peshkimit të përgjegjshëm, duke marrë parasysh të gjitha aspektet e tyre përkatëse biologjike, teknologjike, sociale, ekonomike, mjedisore dhe tregëtare;
- b) përcaktojë parimet dhe kriteret për përpunimin dhe zbatimin e politikave kombëtare për një ruajtje të përgjegjshme të resurseve peshkore, e për menaxhimin dhe zhvillimin e peshkimit të përgjegjshëm;
- c) shërbejë si dokument referimi për të ndihmuar Shtetet të krijojnë ose të përmirësojnë kuadrin legal dhe institucional të nevojshëm për ushtrimin e peshkimit të përgjegjshëm, dhe në formulimin dhe zbatimin e masave të duhura;
- d) krijojë udhëzues të cilët mund të përdoren, ku është e nevojshme, në formulimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe dokumenteve të tjerë legal, si detyruese ashtu edhe vullnetare;
- e) lehtësojë dhe të nxisë bashkëpunimin teknik, financiar e bashkëpunime të tjera në ruajtjen e resurseve peshkore dhe menaxhimin dhe zhvillimin e peshkimit;
- f) nxisë kontributin e peshkimit në sigurinë dhe cilesinë e ushqimit, duke i dhënë prioritet nevojave ushqimore të komuniteteve lokale;
- g) nxisë mbrojtjen e resurseve ujore të gjalla, mjedisëve të tyre dhe zonave bregdetare;
- h) nxisë tregëtine e peshkut dhe produktet e peshkimit në përputhje me rregullat ndërkombëtare përkatëse dhe të evitojë përdorimin e masave që krijojnë bariere të fshehta për këtë lloj tregëtie;
- i) nxisë kërkimin shkencor në peshkim si në drejtim të ekosistemeve përkatëse ashtu edhe të faktorëve mjedisore të tyre;
- j) japë modele të drejtimit për të gjithë personat e përfshirë në sektorin e peshkimit.

NENI 3 - MARRËDHËNIET ME DOKUMENTA TË TJERË NDËRKOMBËTARE

3.1 Kodi duhet interpretuar dhe zbatuar në konformitet me rregullat përkatëse të ligjit ndërkombëtar, siç është shkruar në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Detit, 1982. Në këtë Kod nuk cenohen të drejtat, juridiksioni dhe detyrat e Shteteve sipas ligjit ndërkombëtar të shprehura në Konventë.

3.2 Kodi gjithashtu duhet të interpretohet dhe zbatohet:

- a) në përputhje me klauzolat përkatëse të Marrëveshjes për Zbatimin e Masave të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Detit të 10 dhjetorit 1982 (Agreement for the Implementation of the Provisions of the United Nations Convention on the Law of the Sea of 10 December 1982) në lidhje me Ruajtjen dhe Menaxhimin e tufave të mbivendosura dhe

tufat (rezervat) migratoreve tipike (Relating to Conservation and Management on Straddling Fish Stocks and Highly Migratory Fish Stocks);

- b) në përputhje me rregullat e tjera të zbatueshme të ligjit ndërkombëtar, duke përfshirë detyrimet përkatëse të Shteteve në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat ato kanë aderuar;
- c) në bazë të Deklarates së Cancun të 1992, Deklarates së Rio të 1992 mbi Mjedisin dhe Zhvillimin, dhe Agjendes 21 pershtatur nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin dhe Zhvillimin (UNCED), në vecanti kapitulli 17 i Agjendes 21, dhe deklarata dhe dokumenta të tjerë të rëndësishme ndërkombëtare.

NENI 4 – ZBATIMI, MONITORIZIMI DHE AGJIORNIMI

4.1 Të gjithë anëtarët dhe jo-anëtarët e FAO-s, entitetet e peshkimit dhe organizmat përkatëse, nënrajonale, rajonale dhe globale, qeveritare ose jo-qeveritare, dhe të gjithë personat të përfshirë në ruajtjen, menaxhimin dhe përdorimin e resurseve peshkore dhe tregëtin e peshkut dhe produkteve të peshkimit duhet të bashkëpunojnë në plotësimin dhe zbatimin e objektivave të Kodit.

4.2 FAO në përputhje me mandatin e saj brenda sistemit të Kombeve të Bashkuara, do të monitorizojë zbatimin dhe vënjen në jetë të Kodit dhe efektet e tij mbi peshkimin dhe Sekretariati si rrjedhim do të raportojë Komitetit të Peshkimi (COFI). Të gjitha shtetet, anëtare ose jo të FAO-s, si dhe organizmat qeveritare dhe joqeveritare, duhet të bashkëpunojnë aktivisht me FAO-n në këtë drejtim.

4.3 FAO, nëpërmjet organeve të saj kompetente, mund të rishikojë Kodin, duke marrë parasysh zhvillimet në peshkim si dhe raportet për Komitetin e Peshkimit (COFI) mbi zbatimin e Kodit.

4.4 Shtetet dhe organizmat ndërkombëtare, qeveritare ose jo-qeveritare, duhet të nxisin të kuptuarit e Kodit ndërmjet atyre që përfshihen në peshkim, dhe duke futur ku është e mundur, skema lehtësuese për pranimin vullnetar të Kodit dhe zbatimin efektiv të tij.

NENI 5 –NEVOJA TË VECANTA PËR VENDET NË ZHVILLIM

5.1 Kapaciteti i vendeve në zhvillim për të zbatuar rekomandimet e këtij Kodi në mënyrë të detyrueshme duhet të merret parasysh sic duhet.

5.2 Më qëllim për të arritur objektivat e këtij Kodi dhe për të mbështetur zbatimin efektiv të tij, vendet, organizmat përkatëse ndërkombëtare, qeveritare ose jo-qeveritare, dhe institucionet financiare duhet të japin miratim të plotë për rrethanat dhe nevojat e vecanta të vendeve në zhvillim, duke përfshirë në vecanti më pak të zhvilluarit midis tyre, dhe vendet në zhvillim të ishujve të vegjël. Shtetet, organizmat përkatëse ndër-qeveritare dhe jo-qeveritare dhe institucionet financiare duhet të punojnë për marrjen e masave në lidhje me nevojat e vendeve në zhvillim, veçanërisht në sferën e ndihmës financiare dhe teknike, transferimit të teknologjise, bashkëpunimit shkencor dhe training dhe në rritjen e aftësisë së tyre si për të zhvilluar peshkimin në vendet e tyre

dhe pjesëmarrjen në peshkimin në det të hapur (ujrat nderkombetare), duke u përfshirë në të tilla peshkime.

NENI 6 -PARIMET E PERGJITHSHME

6.1 Shtetet dhe përdoruesit e resurseve ujore të gjalla duhet të ruajnë ekosistemet ujore. E drejta për të peshkuar mbart në vetvete detyrimin për të vepruar kështu në një mënyrë të përgjegjshme, në mënyrë që të sigurohet ruajtje dhe menaxhim efektiv të resurseve ujore të gjalla.

6.2 Menaxhimi i peshkimit duhet të nxisë mbajtjen e cilësisë, diversitetit dhe egzistencën e resurseve peshkore në sasi të mjaftueshme për brezat e tanishëm e të ardhshëm, në kontekstin e sigurimit ushqimor, zbutjes së varferisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Masat menaxhuese nuk duhet vetëm të sigurojnë ruajtjen e specieve kryesore të peshkuara (target species) por gjithashtu të specieve që i përkasin të njëjtit ekosistem ose që shoqërohen ose varen nga target species.

6.3 Shtetet duhet të ndalojnë mbipeshkimin dhe mbi kapacitetin e peshkimit dhe duhet të zbatojnë masat menaxhuese për të siguruar që sforcë e peshkimit të jetë i krahasueshëm me kapacitetin prodhues të resurseve peshkore dhe përdorimin e tyre të qëndrueshëm. Shtetet duhet të marrin masa për të rehabilituar popullatat në kufijt e të mundshmes dhe kur është e përshtatshme.

6.4 Vendimet për ruajtjen dhe menaxhimin e peshkimit duhet të jenë bazuar në evidencën më të mirë shkencore të disponueshme, gjithashtu duke marrë parasysh njohuritë tradicionale për resurset dhe habitatet e tyre, si dhe faktorët përkates mjedisor, ekonomike e sociale. Shtetet duhet të japin përparësi kërkimeve shkencore dhe mbledhjes së të dhënave me qëllim përmirsimin e njohurive shkencore e teknike të peshkimit, duke përfshirë bashkëveprimin e tij me ekosistemet. Duke njohur natyrën nderkufitare të shumë ekosistemeve ujore, Shtetet duhet të inkurajojnë, kur është e mundur, bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh në kërkime shkencore.

6.5 Shtetet dhe organizmat menaxhuese të peshkimit nënrajonal dhe rajonal duhet të zbatojnë metoda parandaluese për ruajtjen, menaxhimin dhe shfrytëzimin e resurseve ujore të gjalla me qëllim për të mbrojtur ato dhe për të ruajtur mjedisin ujor, duke marrë parasysh evidencën shkencore me të mirë të disponueshme. Mungesa e informacionit shkencor adekuat nuk duhet përdorur si justifikim për shtyrjen ose mosmarrjen e masave në ruajtjen e specieve target (kryesore të peshkuara), specieve të bashkëlidhura dhe të ndërvarura, jo target dhe mjedisit të tyre.

6.6 Praktikët dhe mjetet e peshkimit selektiv dhe ruajtese të mjedisit duhet të zhvillohen dhe të zbatohen me tej, në mënyrë të gjere praktike, me qëllim që të ruajnë biodiversitetin dhe strukturën e popullatës dhe ekosistemet ujore dhe të mbrojnë cilësinë e peshkut. Ku ekzistojnë praktika dhe mjete peshkimi të rregullta selektive e mjedisore të sigurta, këto duhen pranuar dhe duhet dhënë përparësi marrjes së masave të ruajtjes dhe menaxhimit të peshkimit. Shtetet dhe përdoruesit e ekosistemeve ujore duhet të minimizojnë humbjet, zënjen e specieve non-target, peshk dhe jo-peshk, e pasojat në speciet e asociuara dhe dependente.

6.7 Zënja, trajtimi, perpunimi dhe shpërndarja e peshkut dhe produkteve të peshkimit duhet të kryhet në mënyrë të tillë që të ruajë vlerën ushqimore, cilësinë dhe sigurinë e produkteve, të reduktojë humbjet e të minimizojë ndikimet negative mbi mjedisin.

6.8 Te gjitha habitatet e peshkimit në ekosistemet detare dhe te ujrave te embla, siç jane zonat e lageshta (wetlands), mangroves, barrierat, lagunat, zonat e riprodhimit dhe të rritjes, duhet të mbrohen dhe rehabilitohen sa te jete e mundur dhe ku është e nevojshme. Perpjekje të veçanta duhet të behen per te mbrojtur te tilla habitate nga shkaterrimi, degradimi, ndotja dhe pasoja të tjera te medha nga aktivitete njerezore, qe kercenojnë shendetin dhe mbijetesën e resurseve peshkore.

6.9 Shtetet duhet të sigurohen që interesat e tyre te peshkimit, duke perfshire nevojën per ruajtjen e resurseve, jane marre parasysh ne perdorimet e shumefishta te zones bregdetare dhe jane integruar ne menaxhimin, planifikimin dhe zhvillimin e zones bregdetare.

6.10 Brenda kompetencave te tyre perkatese dhe konform me ligjin nderkombetar, duke perfshire strukturat e organizmave o marreveshjeve nenrajonale ose rajonale per ruajtjen e menaxhimin e peshkimit, Shtetet duhet te konkordojne dhe bashkepunojne ne lidhje me masat per ruajtje dhe menaxhim, dhe te vendosin mekanizma efektive, sic eshte e pershtatshme, per te monitorizuar dhe kontrolluar aktivitetet per anijet e peshkimit dhe anijet mbeshtetese te peshkimit.

6.11 Shtetet qe autorizojnë anijet e peshkimit dhe mbeshtetese të peshkimit per te perdorur flamuret e tyre, duhet te ushtrojne nje kontroll efektiv mbi keto anije, ne menyre qe te sigurojnë zbatimin e duhur te ketij kodi. Shtetet duhet të sigurojnë qe aktivitetet e anijeve të tilla nuk cenojnë efektivitetin e masave ruajtese e manexhuese te marra ne ne perputhje me ligjet nderkombetare dhe te pranuar ne nivel kombetar, nenrajonal, rajonal dhe global. Shtetet duhet te sigurojnë që anijet te cilat perdorin flamurin e tyre te permbushin detyrimet e tyre ne perputhje me mbledhjen dhe sigurimin e të dhenave qe lidhen me aktivitetet e tyre të peshkimit.

6.12 Shtetet, duhet që brënda kompetencave të tyre perkatese dhe ne perputhje me ligjin nderkombetar, te bashkepunojnë ne nivel nenrajonal, rajonal dhe global, nepermjet organizmave menaxhuese të peshkimit, marreveshjeve te tjera nderkombetare ose marreveshjeve te tjera per te nxitur ruajtjen dhe menaxhimin, per te siguruar peshkimin e pergjegjshem dhe per te siguruar ruajtjen dhe mbrojtjen efektive te resurseve ujore te gjalla ne te gjitha zonat e tyre te shtrirjes, duke marrë parasysh nevojën per masa te perputhshme me zonat si brenda dhe jashtë juridiksionit kombetar.

6.13 Shtetet duhet, për sa lejojnë ligjet dhe rregulloret nacionale, te sigurojnë qe proceset e marrjes se vendimeve te jene transparente dhe te arrijne zgjidhjen ne kohe per ceshtje urgjente. Shtetet, ne perputhje me procedurat e duhura, duhet te lehtesojne konsultimin dhe pjesmarrjen efektive të industrise, punonjesve te peshkimit, e te organizatave mjedisore ose te tjerave te interesuara ne marrjen e vendimeve per sa i perket zhvillimit te ligjeve dhe politikave ne lidhje me menaxhimin, zhvillimin, kredive dhe ndihmen nderkombetare per peshkimin.

6.14 Tregetia nderkombetare e peshkut dhe produkteve te peshkimit duhet të drejtohet ne perputhje me parimet, te drejtat dhe detyrimet e percaktuara ne Marreveshjen e Organizates Boterore te Tregetisë (OBT) dhe marreveshjeve te tjera nderkombetare perkatese. Shtetet duhet te sigurojnë qe politikat, programet dhe aktivitetet e tyre ne lidhje me tregetinë e peshkut mos te rezultojne ne konflikt me kete Marrëveshje dhe te mos çojne ne degradim mjedisor ose pasoja negative sociale e ushqimore.

6.15 Shtetet duhet të bashkepunojnë me qëllim që të evitojnë konfliktet. Te gjitha konfliktet që lidhen me aktivitetet dhe praktikën peshkuese duhet të zgjidhen në një mënyrë kooperuese, paqësore dhe të menjehershme, në përputhje me marrëveshjet ndërkombetare të zbatueshme ose siç mund të bëhet dakord midis palëve. Në rastet e konflikteve me boshllëk ligjor, shtetet e implikuara duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për realizimin e akordeve të perkohshme të një nature praktike të cilat në asnjë mënyrë nuk duhet të paragjykojnë rezultatin përfundimtar të procedurës së zgjidhjes së problemit.

6.16 Shtetet, duke njohur rëndësinë shumë të madhe për peshkatarët dhe rritesit e peshkut (akuakultoret) të kuptimit të ruajtjes dhe menaxhimit të resurseve të peshkimit nga të cilat ata varen, duhet të nxisin ndërgjegjësimin për peshkim të përgjegjshëm nëpërmjet edukimit dhe trajnimit. Ata duhet të sigurojnë që peshkatarët dhe akuakultoret të jenë të përfshirë në procesin e formulimit dhe të zbatimit të politikave, edhe përsa i përket lehtësimit në aplikimin e Kodit.

6.17 Shtetet duhet të sigurojnë që mjetet dhe pajisjet e peshkimit, kështu si të gjitha aktivitetet e peshkimit, të jenë në gjendje të të garantojnë kushte jetese dhe punë të sigurt, të shëndetshme, të drejta duke respektuar standardet e pranuar në nivel ndërkombëtar nga organizmat ndërkombëtarë përkatës.

6.18 Duke njohur kontributin e rëndësishme të peshkimit artizanale dhe në shkallë të vogël për punësimin, të ardhurave dhe sigurimin e ushqimit, Shtetet duhet të mbrojnë siç duhet të drejtat e peshkatarëve dhe të punonjësve të peshkimit, vecanërisht të atyre të përfshirë në peshkimin artizanal, në shkallë të vogël dhe për jetesë, për një jetesë normale dhe të sigurt të tyre, për dhënje perparësije hyrjeje, atje ku është e përshtatshme, në zonat dhe resurset peshkimit tradicional të ujërave që ndodhen nën juridiksionin e tyre kombëtar.

6.19 Shtetet duhet të konsiderojnë akuakulturën, duke përfshirë peshkimin e nga rritjet e peshkut (culture – based), si mjete për të nxitur diversifikimin e të ardhurave dhe dietes. Duke bërë këtë, Shtetet duhet të sigurojnë që resurset janë përdorur në mënyrë të përgjegjshme dhe pasojat negative në mjedis dhe në komunitetin lokal të jete në minimum.

NENI 7 - MENAXHIMI I PESHKIMIT

7.1 Të përgjithshme

7.1.1 Shtetet dhe të gjithë ata që përfshihen në menaxhimin e peshkimit duhet, nëpërmjet një politike dhe kuadri legal dhe institucional përshtatshëm, të marrin masa për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm afatgjatë të resurseve të peshkimit. Masat ruajtëse dhe menaxhuese, në nivel lokal, kombëtar, nënrajonal, rajonal, duhet të jenë të bazuara në evidencën më të mirë shkencore dhe të jenë të konceptuara për të siguruar qëndrueshmëri afatgjatë të resurseve peshkore në nivele që të nxisin objektivin e përdorimit të tyre optimal dhe të garantojnë ekzistencën e tyre për brezat e tashme e të ardhshme; konsideratat afatshkurter nuk duhet të komprometojnë këto objektiva.

7.1.2 Brenda zonave nën juridiksionin kombëtar, Shtetet duhet të kërkojnë të identifikojnë palet lokale përkatëse që kanë interesa legjitime në përdorimin dhe menaxhimin e resurseve të peshkimit dhe të përcaktojnë marrëveshje për konsultimin e tyre, për të fituar bashkëpunimin e tyre në arritjen e peshkimit të përgjegjshëm.

7.1.3 Për rezerva (stocks) ndërkufitare të peshkut, tufat e mbivendosura, tufat e peshqëve migratore tipikë dhe tufat e peshqëve në det të hapur (ujra ndërkombëtare), ku keto janë shfrytëzuar nga dy ose më shumë Shtete, Shtetet në fjalë, duke përfshirë Shtetet bregdetare përkatëse në rastin tufat e mbivendosura dhe tufat e peshqëve migratore tipikë, duhet të bashkëpunojnë për të siguruar ruajtje dhe menaxhim efektiv të resurseve. Kjo duhet të arrihet, aty ku është e përshtatshme, nëpërmjet krijimit të organizmave dhe marrëveshjeve të peshkimit dypalëshe, nenrajonal ose rajonal.

7.1.4 Organizmat ose marrëveshjet nenrajonale ose rajonale menaxhuese të peshkimit duhet të përfshijnë përfaqësuesit e Shteteve nën juridiksionin e të cilave ndodhen resurset, si dhe përfaqësuesit nga Shtetet që kanë një interes real në peshkim apo në resurset jashtë juridiksionit kombëtar të tyre. Atje ku ekziston një organizëm ose marrëveshje menaxhuese e peshkimit nenrajonal ose rajonal dhe ka kompetencën për të përcaktuar masa menaxhuese dhe ruajtëse, ato Shtete duhet të bashkëpunojnë duke u bërë anëtar të këtyre organizmave ose duke marrë pjesë në marrëveshje të tilla, dhe duke marrë pjesë aktivisht në punën e tyre.

7.1.5 Një shtet që nuk është anëtar i një organizmi të menaxhimit të peshkimit nenrajonal ose rajonal ose nuk është pjesëmarrës në një marrëveshje të menaxhimit të peshkimit nenrajonal ose rajonal duhet megjithatë të bashkëpunojë, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare përkatëse dhe ligjin ndërkombëtar, në ruajtjen dhe menaxhimin e resurseve përkatëse të peshkimit duke zbatuar çdo masë ruajtëse dhe menaxhuese të përshtatura nga organizmat apo marrëveshjet e mësipërme.

7.1.6 Përfaqësuesit nga organizmat, qeveritare apo joqeveritare, që lidhen me peshkimin duhet të shfrytëzojnë mundësitë për të marrë pjesë në mbledhjet e organizmave ose marrëveshjeve menaxhuese të peshkimit nenrajonal o rajonal si vëzhgues, ose në një formë tjetër, në përputhje me procedurat e organizmave dhe marrëveshjeve në fjalë. Keto përfaqësues duhet të kenë në kohën e duhur të drejtën e konsultimit të dokumentave dhe raporteve të këtyre mbledhjeve, duke respektuar rregullat proceduriale të mbledhjeve.

7.1.7 Shtetet duhet të përcaktojnë, brenda kompetencave dhe mundësive të tyre përkatëse, përputhjen e masave të tyre ruajtëse dhe menaxhuese me ato të organizmave e marrëveshjeve nenrajonale e rajonale, mekanizma efektive për monitorizimin, mbikqyrjen, kontrollin dhe zbatimin e ligjit të peshkimit.

7.1.8 Shtetet duhet të marrin masa për të parandaluar ose eliminuar mbi kapacitetin e peshkimit dhe duhet të sigurojnë që nivelet e sforcos së peshkimit të jenë të krahasueshme me përdorimin e qëndrueshëm të resurseve të peshkimit, në mënyrë që të sigurojnë efektivitetin e masave ruajtëse dhe menaxhuese.

7.1.9. Shtetet dhe organizmat ose marrëveshjet menaxhuese të peshkimit nenrajonat ose rajonal duhet të sigurojnë transparencë në mekanizmat për menaxhimin e peshkimit dhe në procesin e marrjes së vendimeve që lidhen me to.

7.1.10. Shtetet dhe organizmat ose marrëveshjet menaxhuese të peshkimit nenrajonat ose rajonal duhet të garantojnë propagandën e duhur për masat e ruajtjes dhe menaxhimit dhe të sigurojnë që ligjet, rregulloret dhe rregullat e tjera legale që drejtojnë zbatimin e tyre, të jenë të njohura. Përmbajtja dhe qëllimet e masave të tilla duhet t'u shpjegohen përdoruesve të resurseve me qëllim për të lehtësuar zbatimin e tyre, dhe kështu të fitohet një mbështetje më e madhe në zbatimin e të tilla masave.

7.2 Objektivat e menaxhimit

7.2.1 Duke pranuar që përdorimi i qëndrueshëm afat-gjate i resurseve peshkore është objektivi kryesor i ruajtjes dhe menaxhimit, Shtetet dhe organizmat ose marrëveshjet menaxhuese të peshkimit rajonal o nenrajonat duhet, ndër të tjera, të marrin masat e duhura, të bazuara në evidencën më të mirë shkencore të disponueshme, të cilat janë konceptuar për të mbajtur ose ripërteritur rezervat (stocks) në nivele të afta për prodhimin e rendimentit maksimal të qëndrueshëm, të përcaktuar nga faktorët përkatës ekonomikë dhe mjedisore, duke përfshirë nevojat e vecanta të vendeve në zhvillim.

7.2.2 Të tilla masa duhet të garantojnë ndërmjet të tjerave që:

- a) të evitohet tejkalimi i kapacitetit të peshkimit dhe shfrytëzimi i rezerveve (stocks) të mbetet ekonomikisht i qëndrueshëm;
- b) kushtet ekonomike nën të cilat punojnë industritë e peshkimit të nxisin peshkimin e përgjegjshëm;
- c) interesat e peshkatarëve, duke përfshirë edhe ata në peshkimin për jetesë, në peshkimin në shkallë të vogël dhe artizanal, të jenë marrë në konsideratë;
- d) të ruhet biodiversiteti i habitateve dhe ekosistemeve ujore dhe të mbrohen speciet në rrezik;
- e) të lejohet rezerva (stocks) shumë të shfrytëzuar të kthehen në gjëndje normale, ku është e përshtatshme, në mënyrë aktive të ripërtërihen;
- f) të vlerësohen pasojat (impakti) negative mjedisore mbi resurset nga aktivitetet njëzore dhe, ku është e mundur, të korrigjohen;
- g) të zvogëlohet pasojat (impakti) i ndotjes, mbeturinave, hedhjeve, zënies së peshkut me mjete të humbura e të abandonuara, zënia e specieve non-target, për speciet peshkore dhe jo-peshkore, dhe impakti mbi speciet e shoqeruara dhe dependente, nëpërmjet masave që garantojnë, ku është e mundur, zhvillimin dhe përdorimin e mjeteve dhe teknikave të peshkimit selektiv, me leverdi ekonomike dhe të sigurta nga pikepamja mjedisore.

Shtetet duhet të vleresojnë impaktin e faktoreve mjedisore mbi rezervat peshkore më të peshkuara (target stocks) dhe speciet që i perkasin të njëjtit ekosistem ose të varura o të shoqeruara nga target stocks, dhe të përcaktojnë relacionet midis popullatave në ekosistem.

7.3 Struktura dhe procedurat e menaxhimit

7.3.1 Për të qënë efektiv, menaxhimi i peshkimit duhet të përfshijë të tërë njësinë stock në të tërë zonën e tij të shpërndarjes dhe të marrë parasysh sic është rënë dakord më parë masat menaxhuese të percaktuara dhe zbatuara në të njëjtin rajon, të gjitha zhvendosjet dhe njësinë biologjike dhe karakteristikat e tjera biologjike të stock. Evidenca më e mirë shkencore e disponueshme duhet të perdoret për të përcaktuar, ndër të tjera, zonën e shpërndarjes së resurseve dhe zonën nëpërmjet së ciles ato migrojnë gjate ciklit të tyre të jetes.

7.3.2 Me qëllim për të ruajtur dhe menaxhuar rezervat (stocks) e peshqëve ndërkufitarë, tufat e mbivendosura, tufat e peshqëve migratore tipikë dhe tufat e peshqëve të ujrave ndërkombëtare (në det të hapur) në të gjithë shtrirjen e tyre, masat ruajtëse dhe menaxhuese të percaktuara për të tilla rezeva (stocks) në përputhje me kompetencat respektive të Shteteve përkatëse ose, ku është e përshtatshme, nëpërmjet organizmave dhe marrëveshjeve menaxhuese të peshkimit nenrajonale dhe rajonale, duhet të jenë të përputhshme. Përputhshmëria duhet të arrihet në mënyrë koherente me të drejtat, kompetencat dhe interesat e Shteteve të interesuara.

7.3.3 Objektivat menaxhuese afat-gjate duhet të kalojnë në veprime menaxhuese, të formuluar si një plan menaxhues peshkimi ose struktura të tjera menaxhues.

7.3.4 Shtetet dhe, ku eshte e përshtatshme, organizmat dhe marrëveshjet menaxhuese të peshkimit nenrajonale dhe rajonale duhet të inkurajojnë dhe të nxisin bashkëpunimin dhe kordinimin ndërkombëtar në të gjitha problemet që lidhen me peshkimin, duke përfshirë mbledhjen dhe shkëmbimin e informacionit, kërkimin shkencor, menaxhimin dhe zhvillimin e peshkimit.

7.3.5 Shtetet që, nëpërmjet një organizate jo-peshkimi, duan të ndërmarrin veprime që mund të ndikojnë në masat ruajtëse dhe menaxhuese të ndërmarrja nga organizma ose marrëveshje menaxhues peshkimi nenrajonale ose rajonale kompetent, duhet të konsultohen me këta të fundit duke marrë në konsideratë masat që kanë përcaktuar ato.

7.4 Mbledhja e të dhënave dhe keshilla menaxhuese

7.4.1 Marrja e masave ruajtëse dhe menaxhuese, duhet të bazohet në evidencën më të mirë shkencore të disponueshme me qëllim që të vlerësohet gjendja aktuale e resurseve peshkore dhe ndikimi (impakti) i mundëshme i masave të propozuara mbi resurset.

7.4.2 Duhet të nxitet kërkimi shkencor në mbështetje të ruajtjes dhe menaxhimit të peshkimit, duke përfshirë kërkimet mbi resurset dhe mbi efektet e faktoreve klimatike, mjedisore dhe social-ekonomike. Rezultatet e këtyre kërkimeve shkencore duhen të bëhen të njohura të gjitha paleve të interesuara.

7.4.3 Duhet të nxiten studime në lidhje me shpenzimet, përfitimet dhe efektet të opsioneve menaxhuese alternative të projektuara për të racionalizuar peshkimin, në vecanti, opsionet që lidhen me mbi kapacitetin e peshkimit (excess fishing capacity) dhe me nivele të larta të sforcos së peshkimit.

7.4.4 Shtetet duhet të sigurojnë që statistikën në kohë, të plotë dhe të besueshme mbi zënjen e peshkut dhe sforcën e peshkimit të jenë grumbulluar dhe mbajtur në përputhje me standartet dhe praktikën ndërkombëtare të zbatueshme, të detajuara, që garantojnë një analizë statistikë të sakte. Këto të dhëna duhet të agjiornohen rregullisht dhe duhen verifikuar nëpërmjet një sistemi të përshtatshëm. Shtetet duhet të plotësojnë dhe shpërndajnë këto të dhëna në mënyrë koherente.

7.4.5 Nëpërmjet mbledhjes së të dhënave, analizës dhe kërkimit duhet të zhvillohen njohuri të mjaftueshme të faktorëve sociale, ekonomike dhe institucionale me qëllim që të sigurohet një menaxhim i qendrueshëm i peshkimit dhe për të bërë të mundur që të realizohen objektivat ekonomike dhe sociale.

7.4.6 Shtetet duhet të plotësojnë të dhëna që lidhen me peshkimin dhe të dhëna të tjera mbështetëse shkencore lidhur me rezervat (stocks) e peshkut, që mbulohen nga organizma ose marrëveshje menaxhuese të peshkimit nënrajonale ose rajonale, në një format të pranuar ndërkombëtar dhe pastaj ta dërgojnë në kohë organizmave ose marrëveshjeve të mësipërme. Në rastin e stocks të cilat ndodhen nën juridiksionin e më shumë se një shteti dhe për të cilat nuk ekziston asnjë organizëm ose marrëveshje e lartpërmendur, Shtetet e interesuara duhet të bien dakort për mekanizmat e bashkëpunimit të mbledhjes dhe shkëmbimit të dhënave të cituara më sipër.

7.4.7 Organizmat ose marrëveshjet menaxhuese të peshkimit, nënrajonale ose rajonale, duhet të mbledhin të dhëna dhe të bëjnë ato të njohura, në mënyrë koherente me kërkesat e zbatueshme të sekretit, në kohën e duhur dhe me një format të pranuar nga të gjithë anëtarët e këtyre organizmave dhe palet e tjera të interesuara në përputhje me procedurat e pranuar.

7.5 Metoda parandaluese

7.5.1 Shtetet duhet të zbatojnë gjëresisht metodën parandaluese për ruajtjen, menaxhimin dhe shfrytëzimin e resurseve ujore të gjalla me qëllim për të mbrojtur ato dhe për të ruajtur mjedisin ujor. Mungesa e informacione adekuate shkencore nuk duhet përdorur si pretekst për të shtyre ose heqjen dorë të masave ruajtëse dhe menaxhuese.

7.5.2 Në zbatimin e metodave parandaluese, Shtetet duhet të marrin parasysh, ndër të tjera, pasaktësinë në lidhje me madhësinë dhe produktivitetin e stocks, pikat e referimit, kushtet e stocks në lidhje me pika të tilla referimi, nivelet dhe shpërndarja e mortalitetit peshkor dhe impakti mbi aktivitetet e peshkimit, duke përfshirë hedhjet e specieve non-target dhe të shoqeruara ose të varura, si dhe kushtet mjedisore dhe social-ekonomike.

7.5.3 Shtetet dhe organizmat ose marrëveshjet menaxhuese të peshkimit nënrajonal dhe rajonal duhet, mbi bazën e evidencës më të mirë shkencore të disponueshme, ndër të tjera, të përcaktojnë:

a) pikat e referimit të target për stokck të veçante, dhe në të njëjten kohe, veprimet që duhen ndërmarrë në qoftë se ato janë tejkaluar; dhe

b) pikat e referimit limit për stock te veçante, dhe ne te njejten kohe, veprimet qe duhen ndermarrë në qofte se ato janë tejkaluar; kur arrihet afër një pikë reference limite, duhet te ndërmerren masa për të siguruar që ajo nuk do të tejkalohet.

7.5.4 Ne rastet e peshkimeve te reja ose eksploruese, Shtetet duhet të marrin sa më shpejt të jetë e mundur masa ruajtëse dhe menaxhuese te kujdesëshme, duke përfshire, ndermjet të tjerave, kufijte e zënies dhe kufijte e sforcos së peshkimit. Masa të tilla duhet të qëndrojnë në fuqi derisa të arrihet mbledhja e të dhënave të mjaftueshme që lejojnë vlerësimin e impaktit të peshkimit në qëndrueshmëri afatgjate të stocks; mbi këto gjithashtu duhen zbatuar masa te ruajtjes dhe menaxhimit te bazuar ne kete vleresim. Keto masa te fundit duhet, nese janë adeguate, te lejojnë zhvillimin gradual të peshkimit.

7.5.5 Në qoftë se një fenomen natyral rezulton të ketë një impakt të konsiderueshëm negativ mbi statusin e resurseve ujore të gjalla, Shtetet duhet të marrin masa ruajtëse dhe menaxhuese emergjente për të siguruar qe aktiviteti i peshkimit mos te ashpersojë kete impaktt negativ. Këto masa emergjente duhen marrë gjithashtu në rastin në te cilin aktiviteti i peshkimit paraqet një kërcënim serioz në mbijetesën e këtyre resurseve. Masat emergjente duhet të kenë karakter të përkohshëm e të jenë të bazuara në evidencën më të mirë shkencore të disponueshme.

7.6 Masa menaxhuese

7.6.1 Shtetet duhet të sigurojnë që niveli i lejuar i peshkimit është i përputhshem me gjendjen e resurseve peshkore.

7.6.2 Shtetet duhet të marrin masa për të siguruar që anijet të lejohen të peshkojnë të jenë me autorizim, në menyre koerente me ligjin nderkombëtar për ujrat nderkombëtare ose në përputhje me legjislacionin kombëtar brenda zonave të juridiksionit kombëtar.

7.6.3 Atje ku mbi kapaciteti i peshkimit ekziston, duhet të percaktohen mekanizma për të reduktuar kapacitetin në nivele të përputhshme me përdorimin e qëndrueshëm të resurseve peshkore, për te siguruar që peshkataret të punojnë nën kondita ekonomike që nxisin peshkimin e përgjegjshëm. Të tilla mekanizma duhet të përfshijnë monitorizimin e kapacitetit të flotave të peshkimit.

7.6.4 Duhet egzaminuar karakteristikat e gjithë mjeteve, metodave dhe praktikave ekzistuese të peshkimit dhe të merren masa për të siguruar që mjetet, metodat dhe praktikat që nuk jane të përputhshme me peshkimin e përgjegjshem te eliminohen dhe zevendesohen me alternativa me te pranueshme. Ne këtë proces, vemendje e vecante duhet ti jepet pasojave (impaktit) të ketyre masave mbi komunitetet e peshkimit, duke përfshire aftesine e tyre për të shfrytëzuar resurset.

7.6.5 Shtetet dhe organizmat ose marreveshjet menaxhuese të peshkimit duhet të rregullojnë peshkimin në menyre të tillë që të evitojnë rrezikun e konfliktit midis peshkatareve që perdorin anije, mjete dhe metoda peshkimi të ndryshme.

7.6.6 Kur vendoset mbi perdorimin, ruajtjen dhe menaxhimin e resurseve të peshkimit, duhet të kihet parasysh, ku është rasti, që të jenë në përputhje me ligjet dhe rregulloret kombetare, praktikat tradicionale, nevojat dhe interesat të popullatës autoktone dhe komuniteteve lokale të peshkimit që varen gjërësisht nga resurset peshkore për mbijetesën e tyre.

7.6.7 Në vlerësimin masave alternative ruajtjes dhe menaxhuese, duhet marrë në konsideratë kosto-fitimi dhe impakti social i tyre.

7.6.8 Efikasiteti i masave të ruajtjes dhe menaxhimit dhe ndërveprimet e tyre të mundshme duhet të mbahen në agjiornim të vazhdueshëm. Këto masa duhet, ku është rasti, të rishikohen ose të hiqen duke u mbështetur në informacionet e reja.

7.6.9 Shtetet duhet të marrin masat e duhura për të minimizuar mbeturinat, hedhjet, zënjen me mjete të humbura e të abandonuara, zënjen e specieve non-target, speciet iktike dhe jo-iktike, dhe pasojat (impaktet) negative për speciet e shoqeruara dhe dependente, në vecanti speciet në rezik. Ku është e përshtatshme, masa të tilla mund të përfshijnë masa teknike që lidhen me madhësinë e peshkut, madhësinë e syzes së rrjetës ose mjetit, hedhjet, ndalimin e peshkimit në sezona dhe zonave të caktuara, zonat e rezervuara për peshkimin selektiv, në vecanti peshkim artizanal. Të tilla masa duhet të zbatohen, ku është e përshtatshme, për të mbrojtur rrasat dhe riprodhuesit. Shtetet dhe organizmat ose marreveshjet menaxhuese në rajonale e rajonale duhet të nxisin, sa të jete e mundur, zhvillimin dhe perdorimin e mjeteve dhe teknikave selektive, që respektojnë mjedisin dhe me leverdi ekonomike.

7.6.10 Shtetet dhe organizmat ose marreveshjet menaxhuese të peshkimit në rajonale dhe rajonale, në kuadrin e kompetencave të tyre përkatëse, duhet të paraqesin masa për resurset e ezauruara dhe ato rezerva të kercënuara në ezaurim, që lehtësojnë ripërteritjen e qëndrueshme të këtyre rezervave (stocks). Ata duhet të bëjnë çdo përpjekje për të siguruar që resurset dhe habitatet kritike për mirëqenien e këtyre resurseve, të cilat kanë qene në rrezik nga pasojat e peshkimit ose nga aktivitete të tjera njëzore janë grumbulluar, të ripertërihen.

7.7 Zbatimi

7.7.1 Shtetet duhet të sigurojnë krijimin e një kuadri efektiv legal dhe administrativ në nivel lokal dhe kombëtar për ruajtjen e resurseve peshkore dhe menaxhimin e peshkimit.

7.7.2 Shtetet duhet të sigurojnë që ligjet dhe rregulloret të parashikojnë sanksione të zbatueshme dhe efektive në lidhje me shkelje të ndryshme, duke përfshirë sanksionet që lejojnë mos dhënjën, tërheqjen dhe pezullimin e licensës së peshkimit në rastet e shkeljeve të normave në fuqi për ruajtje dhe menaxhim.

7.7.3 Shtetet, në përputhje me ligjet e tyre kombëtare, duhet të zbatojnë monitorizim efektiv të peshkimit, kontroll, mbikqyrje dhe masa detyruese ligjore duke përfshirë, ku është e përshtatshme,

programet vezhguese, skema inspektimi dhe sisteme monitorizimi te anijeve. Masa te tilla duhen nxitur dhe, ku është e mundur, duhen zbatuar nga organizmat dhe marrëveshjet nenrajonale e rajonale manexhuese të peshkimit në perputhje procedurat e pranuar prej tyre.

7.7.4 Shtetet dhe organizmat ose marreveshjet nenrajonale e rajonale manexhuese të peshkimit, ku është e përshtashme, duhet të bien dakort mbi burimet e financimit të aktiviteteteve të këtyre organizmave dhe marrëveshjeve, duke patur parasysh, ndermjet të tjerave, përfitimet relative që rrjedhin nga peshkimi dhe mundesitë e ndryshme të vendeve për të siguruar kontribute financiare dhe te kontribute te tjera.

7.7.5 Shtetet që jane anëtare ose pjesmarres ne organizmat ose marreveshjet nenrajonale e rajonale manexhuese te peshkimit, duhet te zbatojne masa, te pranuar ne nivel nderkombetar dhe te pershtatura ne keto organizma ose marreveshje dhe konform me ligjin nderkombetar, per te ndaluar aktivitetet e anijeve qe mbajne flamurin e jo-anetareve ose jo-pjesmarresve dhe qe jane te angazhuar ne aktivite qe prishin efektivitetin e masave ruajtese dhe menaxhuese te vendosura nga organizmat ose marreveshjet e lartpermendura.

7.8 Institucionet financiare

7.8.1 Pa paragjykim për marreveshjet nderkombetare perkatese, Shtetet duhet te inkurajojne bankat dhe institucionet financiare të mos kerkojne, si nje kusht per nje hua ose hipoteke, anijet e peshkimit ose anijet mbeshtetese te peshkimit te kene flamur te ndryshem nga ai i shtetit tecilit i perkasinku, ku nje kerkese e tille mund te rrise mundesine e mos-perputhjes me masat per ruajtjen dhe menaxhimin nderkombetar.

NENI 8 – AKTIVITETET E PESHKIMIT

8.1 Detyrat e të gjitha Shteteve

8.1.1 Shtetet duhet të sigurojnë qe brenda ujrave nen juridiksionin e tyre, të zhvillohen vetëm aktivitet e peshkimit te lejuararan nga ato, dhe keto aktivite jane kryer ne nje menyre te pergjegjshme.

8.1.2 Shtetet duhet te mbajne një rregjistrim, te agjiornuar ne intervale te rregullta, per te gjitha autorizimet (licensat) e peshkimit te leshuara prej tyre.

8.1.3 Shtetet duhet të mbajnë, në perputhje me standartet dhe praktiket e njohura nderkombetare, të dhënat statistikore, të agjiornuara në intervale të rregullta, për të gjitha aktivitetet e peshkimit të lejuara prej tyre.

8.1.4 Shtetet duhet, në perputhje me ligjin nderkombetar, brënda kuadrit të organizmave ose marrëveshjeve nenrajonale e rajonale manexhuese të peshkimit, të bashkepunojnë per te krijuar sisteme per monitorizimin, kontrollin, mbikqyrjen dhe zbatimin e masave të zbatueshme ne lidhje me aktivitet e peshkimit dhe aktivitetet qe lidhen me to ne ujrat jashte juridiksionit të tyre kombëtar.

8.1.5 Shtetet duhet të sigurojnë që të jenë pershtatur standartet sanitare dhe të sigurojnë për të gjithë personat e punësuar në aktivitetet e peshkimit. Këto norma duhet të paktën të përfshijnë kërkesat minimale të marrëveshjeve ndërkombëtare përkatëse të kushteve të punës dhe të shërbimit.

8.1.6 Shtetet duhet të ndermarrin individualisht masa, së bashku me Shtetet e tjera ose me organizatat e duhur ndërkombëtare për të integruar aktivitetet e peshkimit në sistemet e kerkimit dhe shpëtimit detar.

8.1.7 Shtetet duhet të rrisin nëpërmjet programeve të edukimit dhe trainimit edukimin dhe aftësitë e peshkatarëve, dhe ku është e pershtatshme, kualifikimin e tyre profesional.

8.1.8 Shtetet duhet, ku të jetë e pershtatshme, të mbajnë regjistra për peshkatarët të cilat duhet, se është e mundshme, të përmbajnë informacion mbi shërbimet dhe kualifikimet e tyre, duke përfshirë certifikatat e kompetencës, në përputhje me ligjet e tyre kombëtare.

8.1.9 Shtetet duhet të garantojnë që masat e zbatueshme ndaj kapiteneve e anijeve dhe të ngarkuarëve të tjerë që kanë përgjegjësi në shkeljet që lidhet me veprimtarinë e anijes së peshkimit, duhet të përmbajë klauzola të cilat mund të lejojnë, ndërmjet të tjerash, refuzimin, tërheqjen ose pezullimin e autorizimeve për të shërbyer si kapitene ose oficerë të një anije peshkimi.

8.1.10 Shtetet, me asistencën e organizmave ndërkombëtare përkatëse, duhet të përpiqen për të siguruar nëpërmjet edukimit dhe trainimit që të gjithë të angazhuarëve në veprimtaritë e peshkimit t'u jepet informacion mbi klauzolat më të rëndësishme të këtij kodi, mbi klauzolat për konventat përkatëse ndërkombëtare dhe standartet të zbatueshme mjedisore dhe të tjera që janë thelbësore për të siguruar aktivitetet e peshkimit të përgjegjshëm.

8.2 Detyrat e Shtetit flamurbajtës

8.2.1 Shtetet flamurbajtës duhet të mbajnë regjistra të anijeve të peshkimit që u është dhënë e drejta të përdorin flamurin e tyre dhe të autorizuar për peshkim, dhe duhet të tregojnë në këto regjistra detaje për anijet, pronësinë e tyre dhe autorizimin për të peshkuar.

8.2.2 Shtetet flamur duhet të sigurojnë që asnjë anije peshkimi që i është dhënë e drejta të përdorë flamurin e tyre, të peshkojë në ujra ndërkombëtare ose në ujra nën juridiksionin e Shteteve të tjera, pa qënë të pajisura me Certificate Rregjistrimi dhe të autorizuar për të peshkuar nga autoritetet kompetente. Këto anije duhet të mbajnë në bord Certificate dhe Regjistrimit dhe autorizimin e tyre për të peshkuar.

8.2.3 Anijet e peshkimit të autorizuar për të peshkuar në ujra ndërkombëtare ose në ujra nën juridiksionin e një Shteti të ndryshëm nga Shteti flamur, duhet të kenë shenjat e identifikimit në përputhje me sistemet e identifikimit uniform të ndërkombëtarisht të njohur të anijeve, siç janë Specifikimet Standarte të FAO-s dhe Udhëzuesit Për Markimin dhe Identifikimin e Anijeve të Peshkimit (FAO Standard Specification and Guidelines for Marking and Identification of Fishing Vessels).

8.2.4 Anijet e peshkimit duhet të kenë shenja identifikimi në përputhje me legjislacionin kombëtar me qëllim që pronari i mjetit të mund të identifikohet. Në kerkesat për identifikimin e mjeteve duhet të merren parasysh sistemet e identifikimit uniform e ndërkombëtarisht të njohur të anijeve të peshkimit.

8.2.5 Shtetet flamur duhet të sigurojnë respektimin dhe kerkesat e duhura të sigurisë për anijet e peshkimit dhe peshkatarët në përputhje me konventat ndërkombëtare, kodet e rregullave ndërkombëtarisht të pranuar dhe udhëzuesve vullnetar. Shtetet duhet të percaktojnë kerkesat e duhura të sigurisë për të gjitha anijet e vogla që nuk mbulohen nga të tilla konventa ndërkombëtare, kodet e rregullave ose udhëzuesit vullnetar.

8.2.6 Shtetet jo pjesmarrese të Marrëveshjes Për Nxitjen e Respektimit të Masave Nderkombetare Ruajtese dhe Menaxhuese nga Anijet e Peshkimit në Ujrat Nderkombetare duhet të inkurajohen për të pranuar Marrëveshjen dhe për të adaptuar ligjet dhe rregulloret në mënyrë koherente me klauzolat e Marrëveshjes.

8.2.7 Shtetet flamur duhet të ndërmarrin masa ndëshkuese për anijet e peshkimit që mbajnë flamurin e tyre, të cilat nuk kanë respektuar masat ruajtëse dhe menaxhuese të aplikueshme, duke e kaluar, ku është e përshtatshme shkeljen e masave tilla në një kundravajtje të legjislacionit kombëtar. Sanksionet e zbatueshme për shkeljet e mësipërme duhet të zbatohen me rreptësi për të qënë efektiv në respektimin e këtyre masave ruajtëse dhe menaxhuese dhe për të frenuar shkeljet kudo që ato ndodhin dhe duhet të privojnë autoritetet e këtyre shkeljeve nga përfitimet e aktiviteteve të tyre ilegale. Të tilla sanksione mundet, për shkelje të rënda, të përfshijnë klauzola për refuzimin, terheqjen ose pezullimin e autorizimit për të peshkuar.

8.2.8 Shtetet flamur duhet të nxisin bërjen e asikuracionit nga pronarët dhe qiradhënësit e anijeve të peshkimit. Pronarët dhe qiradhënësit e anijeve të peshkimit duhet të kenë asikuracion të mjaftueshëm për ekuipazhin dhe interesat e tyre, kundra humbjeve dhe dëmeve dhe të mbrojnë interesat e tyre.

8.2.9 Shtetet Flamur duhet të garantojnë që anëtarët e ekuipazhit të kenë të drejtën për riatdhesim, duke marrë parasysh parimet e parashtruara në “Konventën e Riatdhesimit të Detareve” (“Repatriation of Seafarers Convention”, 1987).

8.2.10 Në rastin e një aksidenti të një anije peshkimi ose personave në bordin e një anije peshkimi, Shteti flamur i anijes së peshkimit për të cilën bëhet fjalë duhet të praqesë në detaje aksidentin shtetit për secilin shtetas të huaj në bordin e anijes së aksidentuar. Ky lloj informacioni duhet gjithashtu, ku është e praktikueshme, të komunikohet në Organizatën Detare Ndërkombëtare (International Maritime Organization).

8.3 Detyrat e Shtetit Port

8.3.1 Nëpërmjet procedurave të përcaktuara në legjislacionin e tyre kombëtar, në përputhje me ligjin ndërkombëtar, duke përfshirë marrëveshjet ose akordet ndërkombëtare, Shtetet Port duhet të ndërmarrin masa të tilla që janë të nevojshme për të realizuar vete dhe për të ndihmuar Shtetet e tjera arritjen e objektivave të këtij Kodi, dhe duhet të bëjnë të njohur Shteteve të tjera detaje të

rregulloreve dhe masave që ata kanë percaktuar për këtë qëllim. Kur ndërmarrin të tilla masa, një Shtet Port nuk duhet të diskriminojë në formë ose në substancë anijet e ndonjë Shteti tjetër.

8.3.2 Shtetet Port duhet të sigurojnë asistencën e duhur Shteteve Flamur, në përputhje me ligjet kombëtare të Shtetit Port dhe ligjit ndërkombëtar, kur një anije peshkimi është vullnetarisht në një port ose në një terminal në det të hapur të Shtetit Port dhe Shteti Flamur i anijes i kërkon Shtetit Port asistencë në lidhje me mos respektimin e masave ruajtëse dhe menaxhuese nenrajonale, rajonale ose globale ose të standarteve minimale të pranuar ndërkombëtarisht për parandalimin e ndotjes dhe për sigurimin, shëndetin dhe kushtet e punës në bordin e anijeve të peshkimit.

8.4 Aktivitetet e Peshkimit

8.4.1 Shtetet duhet të sigurojnë që peshkimi të drejtohet në respektimin e sigurimit të jetës njerëzore dhe Rregulloreve Nderkombetare të Organizimit Detar Nderkombetar për Parandalimin e Perplasjeve në Det, si edhe në respektimin e kërkesave të Organizatës Ndërkombetare Detare lidhur me organizimin e trafikut detar, mbrojtjen e mjedisit detar dhe parandalimin e dëmeve ose humbjen e mjeteve të peshkimit.

8.4.2 Shtetet duhet të ndalojnë përdorimin e dinamitit, përdorimin e helmeve dhe praktikave pëshkuese të tjera shkatërruese të ngjashme me këto.

8.4.3 Shtetet duhet të bëjnë çdo përpjekje për të siguruar që dokumentacioni në lidhje me aktivitetet e peshkimit, sasitë e zënive të peshkut dhe specieve të tjera jo iktike, dhe për sa i përket hedhjes së peshkut të mbetur, informacionit të kërkuar për vlerësimin e rezervave (stocks) të percaktuar nga organizmat menaxhues përkates, të grumbullohet dhe në mënyrë sistematike të dërgohet këtyre organizmave. Shtetet duhet, sa të jetë e mundur, të percaktojnë programe vezhguese ose skema inspektimi, me qëllim nxitjen për respektimin e masave që janë në fuqi.

8.4.4 Shtetet duhet të nxisin futjen e teknologjise së duhur, duke marrë parasysh kushtet ekonomike, për përdorimin më të mirë dhe kujdes ndaj peshkut të zënë.

8.4.5 Shtetet, me grupet perkatese të industrisë, duhet të inkurajojnë zhvillimin dhe zbatimin e teknologjive dhe metodave operative që reduktojnë mbetjet. Përdorimi i mjeteve dhe praktikave të peshkimit që sjellin hedhjen në det të peshkut të zënë të papërdorshëm (discards) duhet të mos mbështetet dhe duhet të nxitet përdorimi i mjeteve dhe praktikave të peshkimit që rrisin nivelet e mbijetesës së peshkut që arrin të largohet nga rrjeta.

8.4.6 Shtetet duhet të bashkëpunojnë për të zhvilluar dhe zbatuar teknologji, materiale dhe metoda vepruese që të zvogelojnë humbjet e mjeteve të peshkimit dhe efektet e peshkimit fantazme të shkaktuara nga humbja ose abandonimi i mjeteve të peshkimit.

8.4.7 Shtetet duhet të sigurojnë që vlerësimet e implikimeve në shqetësimet e habitatit të jenë bërë përpara futjes në shkallë tregëtare të mjeteve të reja të peshkimit, të metodave dhe veprimeve të reja në një zonë të caktuar.

8.4.8 Duhet nxitur kërkimi shkencor mbi ndikimet (impaktet) mjedisore dhe shoqërore të mjeteve të peshkimit, dhe në vecanti mbi impaktin e këtyre mjeteve mbi biodiversitetin dhe komunitetet bregdetare të peshkimit.

8.5 Selektiviteti i mjeteve të peshkimit

8.5.1 Shtetet duhet të kërkojnë që mjete, metodat dhe praktikat e peshkimit, për sa të jetë e mundur, të jenë në mënyrë të mjaftueshme selektive që të zvogëlojnë humbjet, hedhjet e peshkut të paperdorshëm, zënjen e specieve non-target, iktike dhe jo iktike, impaktet mbi speciet shoqëruese dhe dependente dhe që qëllimi i masave të tilla të mos anashkalohej me sajime teknike. Për sa i përket kësaj peshkatarët duhet të koepojnë në zhvillimin e mjeteve dhe metodave selektive të peshkimit. Shtetet duhet të sigurojnë që informacioni mbi zhvillimet dhe kërkesat e reja të jetë i disponueshëm për të gjithë peshkatarët.

8.5.2 Për të përmiresuar selektivitetin, Shtetet kur hartojnë ligjet dhe rregulloret e tyre, duhet të marrin parasysh shtrirjen e mjeteve, metodave dhe strategjive të peshkimit selektiv të vlefshme për industrinë.

8.5.3 Shtetet dhe institucionet përkatëse duhet të bashkëpunojnë në zhvillimin e metodologjive standarte për kërkime në drejtim të selektivitetit të mjeteve të peshkimit, metodave dhe strategjive të peshkimit.

8.5.4 Duhet të inkurajohet bashkëpunimi ndërkombëtar në lidhje me programet e kërkimit për selektivitetin e mjeteve, metodave e strategjive të peshkimit, për përhapjen e rezultateve të programeve të tilla kërkimit dhe për transferimin e teknologjise.

8.6 Optimizimi i energjisë

8.6.1 Shtetet duhet të nxisin zhvillimin e standarteve dhe udhëzuesve të duhur të cilët duhet të udhëheqin drejt një përdorimi më eficient të energjisë në aktivitetet e zënjes dhe pas zënjes brenda sektorit të peshkimit.

8.6.2 Shtetet duhet të nxisin zhvillimin dhe transferimin e teknologjise në lidhje me optimizimin e energjisë brenda sektorit të peshkimit dhe në vecanti të inkurajojnë pronarët, qiradhenesit dhe menaxherët e anijeve të peshkimit për të përshtatur pajisjet për kursimin e energjisë për anijet e tyre.

8.7 Mbrojtja e mjedisit ujor

8.7.1 Shtetet duhet të përcaktojnë dhe të zbatojnë ligjet dhe rregulloret të bazuara mbi Konventën Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes nga Anijet, 1973, siç është modifikuar nga Protokollin e 1978 (MARPOL 73/78).

8.7.2 Pronaret, qiradhenesit dhe menaxheret e anijeve te peshkimit duhet te sigurohen qe anijet e tyre te jene pajisura me pajisjet e duhura sic kerkohet nga MARPOL 73/78 dhe duhet te kene parasysh instalimin e nje kompaktori ose furre djegie per llojet perkatese te anijeve me qellim trajtimin e mbeturinave te ushqimeve dhe mbeturinave te tjera qe krijohen gjate sherbimit normal te anijes.

8.7.3 Pronaret, qiradhenesit dhe menaxhuessit e anijeve te peshkimit duhet te minimizojne marjen ne bord te mbeturinave te mundshme gjate praktikave te furnizimit.

8.7.4 Ekuipazhi i anijes se peshkimit duhet te jete i familjarizuar me procedurat e duhura te bordit te anijes, me qellim per te siguruar qe shkarkimet te mos kalojne nivelet e percaktuara nga MARPOL 73/78. Te tilla procedura duhet, minimumi te perfshijne eliminimin e mbeturinave vajore dhe trajtimin dhe grumbullimin e mbeturinave te tjera te bordit te anijes.

8.8 Mbrojtja e atmosferes

8.8.1 Shtetet duhet te pershtasin standarte dhe udhezues perkates qe perfshijne klauzola per reduktimin e substancave te demshme ne nxjerrjen e gazrave te shkarkimit.

8.8.2 Pronaret, qiradhenesit dhe menaxheret e anijeve te peshkimit duhet te sigurojne qe anijet e tyre te jene pershtatura me pajisje qe reduktojne shkarkimin e substancave te demshme per ozonin. Anetaret e ekuipazhit te anijeve te peshkimit pergjegjes te ketyre pajisjeve, duhet te jene te praktikuar me perdorimin dhe mirembajtjen e duhur e makinerise ne bord.

8.8.3 Autoritetet kompetente duhet te nxjerrin dispozita ligjore te nevojshme per eliminimin ne menyre progresive te perdorimit te clorofluorokarboneve (CFCs) dhe te substancave ndermjetese, sic jane hidro clorofluorokarboneve (HCFCs) ne sistemet e ftohjes se anijeve te peshkimit, duke siguruar qe industria e ndertimit te anijeve dhe te gjitha ata qe jane te angazhuar ne industrine e peshkimit te jene informuar dhe ti respektojne keto dispozita ligjore.

8.8.4 Pronaret ose menaxhuesit e anijeve te peshkimit duhet te ndermarrin masat e duhura per te rippershtatur anijet ekzistuese me substanca ftohese alternative te CFCs dhe HCFCs dhe substanca alternative te Halons ne instalimet zjarrfikese. Keto substanca alternative duhet te perdoren ne menyre specifike ne te gjitha anijet e reja te peshkimit.

8.8.5 Shtetet dhe pronaret, qiradhenesit dhe menaxheret e anijeve te peshkimit, si dhe peshkataret duhet te ndjekin udhezuesit nderkombetare ne lidhje me eliminimin CFCs, HCFCs dhe te Halons.

8.9 Portet dhe vendet e zbarkimit per anijet e peshkimit

8.9.1 Ne projektimin dhe ndertimin e porteve dhe vendeve te zbarkimit, ndermjet te tjerave, Shtetet duhet te kene parasysh:

të parashikojne vende te sigurta per anijet e peshkimit dhe struktura adequate te sherbimit per anijet, shitesit dhe bleresit;

te sigurojne furnizimi me uje te pishem dhe strukturat sanitare;
te percatojne sistemet te eliminimit te mbeturinave, duke perfshire eliminimin e vajit, ujit vajor dhe mjeteve te peshkimit;
te minimizohet ndotja nga aktivitetet e peshkimit dhe burimet e jashtme; dhe
te percaktohen marreveshje per te luftuar efektet e erozionit dhe sedimentacionit.

8.9.2 Shtetet duhet te krijojne nje kuader institucional per seleksionimin ose permiresimin e vendeve per porte per anijet e peshkimit, i cili te permbaje konsultim midis autoriteteve pergjegjese per menaxhimin e zones bregdetare.

8.10 Braktisja e strukturave dhe materialeve te tjera

8.10.1 Shtetet duhet te sigurojne qe te respekohen standartet dhe udhezuesit per heqjen e strukturave te teperta larg bregut (offshore) te percaktuara nga Organizata Detare Nderkombetare. Shtetet duhet gjithashtu te sigurojne qe autoritetet kompetente te peshkimit te konsultohen perpara se te merren vendimet per abandonimin e strukturave dhe materialeve te tjera nga autoritetet perkatese.

8.11 Barrierat artificiale dhe strukturat e agregimit te peshqeve

8.11.1 Shtetet, atje ku eshte e pershtatshme, duhet te zhvillojne politika per rritjen e popullatave te rezervave (stock) dhe per rritjen e mundesive te peshkimit nepermjet perdorimit te strukturave artificiale, duke respektuar sigurine e lundrimit, ne ose mbi fundin e detit ose ne sipërfaqe. Duhet nxitur kerkimet shkencore lidhur me perdorimin e ketyre strukturave, duke perfshire ndikimin mbi resurset detare te gjalla dhe mbi mjedisin.

8.11.2 Shtetet duhet te sigurojne qe, kur seleksojne materialet qe perdoren ne krijimin e barrierave artificiale si dhe percaktojne vendosjen gjeografike te ketyre barrierave, te jene respektuar klauzolat e konventave nderkombetare perkatese ne lidhje me mjedisin dhe sigurimin e lundrimit.

8.11.3 Shtetet duhet, brenda kuadrit te planeve menaxhuese te zones bregdetare, te krijojne sisteme menaxhuese per barrierat artificiale dhe strukturat te mbajtjes se peshkut. Te tilla sisteme menaxhimi duhet te kerkojne aprovimin per ndertimin dhe vendosjen e ketyre barrierave dhe strukturave dhe te marrin parasysh interesat e peshkatareve, duke perfshire peshkataret artizanale dhe per jetese.

8.11.4 Shtetet duhet te sigurojne qe autoritetet pergjegjese te arkives se te dhenave kartografike dhe hartave te lundrimit, si dhe autoritetet perkatese mjedisore, te jene informuar perpara per vendosjen ose zhvendosjen e barrierave artificiale ose strukturave te mbajtjes se peshkut.

NENI 9 - ZHVILLIMI I AKUAKULTURES

9.1 Zhvillimi i përgjegjshëm i akuakulturës, që përfshin peshkimin e bazuar në speciet ujore të kultivuara (culture-based fisheries), në zonat nën juridiksionin ndërkombëtar

9.1.1 Shtetet duhet të krijojnë, të mbajnë dhe të zhvillojnë kuadrin e duhur legal dhe administrativ që të lehtësojë zhvillimin e akuakultures së përgjegjshme.

9.1.2 Shtetet duhet të nxisin zhvillimin dhe menaxhimin e përgjegjshëm të akuakultures, duke përfshirë një vlerësim preventiv të efekteve të zhvillimit të akuakultures mbi diversitetin gjenetik dhe integritetin e ekosistemit, bazuar në informacionet më të mira shkencore të disponueshme.

9.1.3 Shtetet duhet të krijojnë dhe në mënyrë të rregullt të agjiornojnë planet dhe strategjitë për zhvillimin e akuakultures, sic kërkohet, për të siguruar që zhvillimi i akuakultures të jetë ekologjikisht i qëndrueshëm dhe për të lejuar përdorimin racional të resurseve të bashkepërdorura nga akuakultura dhe aktivitetet e tjera.

9.1.4 Shtetet duhet të sigurojnë që jetesa e komuniteteve lokale dhe aktiviteti i tyre në zonat e peshkimit, mos të ndikohen negativisht nga zhvillimet e akuakultures.

9.1.5 Shtetet duhet të krijojnë procedurë efektive specifike për akuakulturën, për të ndermarre vlerësime dhe monitorizime adeguate mjedisore me qëllim minimizimin e ndryshimeve negative ekologjike dhe pasojave ekonomike dhe sociale që lidhen me to, që rezultojnë nga nxjerrja e ujit, përdorimi i tokës, shkarkimi i ujërave, përdorimi i substancave farmaceutike dhe kimikateve, dhe aktiviteteve të tjera të akuakultures.

9.2 Zhvillimi i përgjegjshëm i akuakulturës, që përfshin peshkimin e bazuar në speciet ujore të kultivuara (culture-based fisheries), brenda ekosistemeve ujore ndërkufitare

9.2.1 Shtetet duhet të mbrojnë ekosistemet ujore ndërkufitare duke mbështetur praktikën e akuakultures së përgjegjshme brenda juridiksionit të tyre kombëtar dhe duke bashkëpunuar në nxitjen e praktikave të akuakultures qëndrueshme.

9.2.2 Shtetet duhet, me respektin e duhur për Shtetet e tyre fqinje dhe në përputhje me ligjin ndërkombëtar, të sigurojnë zgjedhjen e përgjegjshme të specieve, vendosjen dhe menaxhimin e aktiviteteve të akuakultures të cilat mundet të ndikojnë ekosistemet ujore ndërkufitare.

9.2.3 Shtetet duhet të konsultohen me shtetet e tyre fqinje, në mënyrë të pershtatshme, përpara futjeve të specieve jo-autoktone në ekosistemet ujore ndërkufitare.

9.2.4 Shtetet duhet të krijojnë mekanizmat e duhur, sic janë databazat dhe rrjetet informative telematike për të grumbulluar, përpunuar dhe përhapur të dhënat që lidhen me aktivitetet e tyre të akuakultures, me qëllim të lehtësojë bashkëpunimin për planifikimin e zhvillimit të akuakultures në nivel kombëtar, nënrajonal, rajonal dhe global.

9.2.5 Shtetet duhet të bashkëpunojnë në zhvillimin e mekanizmave të duhura, kur kerkohen, për të monitorizuar pasojat (impaktet) e praktikave të përdorura në akuakulturë.

9.3 Përdorimi i resurseve gjenetike ujore për qëllimet të akuakultures, përfshirë peshkimi i bazuar në speciet ujore të kultivuara (culture-based fisheries)

9.3.1 Shtetet duhet të ruajnë diversitetin gjenetik dhe të mbajnë integritetin e komuniteteve dhe ekosistemeve ujore nëpërmjet menaxhimit të përshtatshëm. Në vecanti, përpjekje duhet të ndermerren për të reduktuar në minimum efektet e demshme të futjes së specieve jo-autoktone ose stocks gjenetike të modifikuara të përdorura për akuakulturë, përfshirë peshkimi i bazuar në speciet ujore të kultivuara, veçanërisht atje ku janë mundësi të mëdha për përhapjen e të tilla specieve jo-autoktone ose stocks gjenetike të modifikuara, si brenda ujërave nën juridiksionin e Shteteve të origjinës ashtu dhe në ujrat nën juridiksionin e Shteteve të tjera. Shtetet duhet, kur është e mundur, të përcaktojnë normat e duhura në lidhje të zvogelimit në minimum të efekteteve negative nga pikepamja gjenetike dhe sanitare dhe të evitojnë efektet e ikjes së peshkut të kultivuar në drejtim të stocks natural.

9.3.2 Shtetet duhet të bashkëpunojnë në përpunimin, pranimin dhe zbatimin e kodeve ndërkombëtare të praktikave dhe procedurave për futjen dhe transferimin e organizmave ujore.

9.3.3 Shtetet duhet, me qëllim për të reduktuar në minimum rreziqet e transferimit të sëmundjes dhe efekteve të tjera të demshme mbi stocks natyral dhe të kultivuara, të inkurajojnë marrjen e praktikave të duhura në përmirësimin gjenetik të stocks të riprodhuesve, futjen e specieve jo-autoktone, dhe në prodhimin, shitjen dhe transportin e vezeve, larvave, rasateve, riprodhuesve ose materije të tjera të gjalla. Shtetet duhet të mbështesin përgatitjen dhe zbatimin e kodeve adekuat të praktikave dhe procedurave për këto qëllime.

9.3.4 Shtetet duhet të nxisin përdorimin e procedurave të përshtatshme për seleksionimin e stocks të riprodhuesve dhe prodhimin e vezeve, larvave dhe rasateve.

9.3.5 Shtetet duhet, kur është e përshtatshme, të nxisin kërkimin shkencor dhe kur është e realizueshme, zhvillimin e teknikave të kultivimit për speciet në zhdukje, për të mbrojtur, rëkuperuar dhe përmirësuar këto stocks, duke marrë parasysh nevojën urgjente të ruajtjes së diversitetit gjenetik të specieve në zhdukje.

9.4 Akuakulture të përgjegjshme në nivelin e prodhimit

9.4.1 Shtetet duhet të nxisin praktikën e përgjegjshme të akuakultures në mbështetje të komuniteteve rurale, organizatave të prodhuesve dhe të rritesve (akuakultoreve) të peshkut.

9.4.2 Shtetet duhet të nxisin pjesëmarrjen aktive të rritesve (akuakultoreve) të peshkut dhe komuniteteve të tyre në zhvillimin e praktikave të përgjegjshme në menaxhimin e akuakultures.

9.4.3 Shtetet duhet të mbështesin përpjekjet që përmirësojnë seleksionimin dhe përdorimin e ushqimeve, shtesave ushqimore dhe pleherusve të përshtatshme, duke përfshirë plehrat organike.

9.4.4 Shtetet duhet të nxisin, praktika efektive të menaxhimit të kultivimit dhe për shëndetin e peshkut duke favorizuar masë higjienike dhe vaksinimet. Duhet të sigurojnë përdorimin e sigurte, efektiv e minimal të terapeutëve, hormoneve dhe ilaçeve, antibiotikeve dhe kimikateve të tjera që kontrollojnë sëmundjen.

9.4.5 Shtetet duhet të rregullojnë përdorimin e inputeve kimike në akuakulture të cilat janë të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

9.4.6 Shtetet duhet të kërkojnë që eliminimi i mbeturinave të tilla siç janë mbeturina, balta, peshku i ngordhur ose i sëmurë, ilaçet e tepërta veterinarë dhe të tjera inpute kimike të rrezikshme, nuk duhet të përbejnë një rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

9.4.7 Shtetet duhet të garantojnë sigurinë ushqimore të produkteve të akuakultures dhe të nxisin përpjekjet për të mbajtur cilësinë e produktit dhe për të përmirësuar vlerën e tyre nëpërmjet një kujdesi të veçantë përpara dhe gjatë grumbullimit të prodhimit, përpunimit në vend, magazinimit dhe transportin e produkteve.

NENI 10 - INTEGRIMI I PESHKIMIT NË MENAXHIMIN E ZONËS BREGDETARE

10.1 Kuadri institucional

10.1.1 Shtetet duhet të sigurojnë një politikë të pershtashme, kuadrin legal dhe institucional me qëllim arritjen e një përdorimi të qëndrueshëm dhe të integruar të resurseve, duke marrë parasysh brishtësinë e ekosistemeve bregdetare dhe natyrën e fundme të resurseve të tyre natyrore dhe nevojat e komuniteteve bregdetare.

10.1.2 Në lidhje me përdorimet e shumefishta të zonës bregdetare, Shtetet duhet të sigurojnë që përfaqësuesit e sektorit të peshkimit dhe komuniteteve të peshkimit të jenë konsultuar në proceset e marrjes së vendimeve dhe të përfshihen në aktivitetet e tjera që lidhen me planifikimin dhe zhvillimin e menaxhimit të zonës bregdetare.

10.1.3 Shtetet duhet të zhvillojnë, si të jetë e pershtatshme, kuadrin institucional dhe legal me qëllim përcaktimin e përdorimeve të mundshme të resurseve bregdetare dhe administrimin e lejimit të përdorimit të këtyre resurseve duke marrë parasysh të drejtat e komuniteteve të peshkimit bregdetar dhe praktikën tradicionale të tyre, për sa janë në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm.

10.1.4 Shtetet duhet të mbështesin futjen e praktikave të peshkimit që evitojnë konfliktin midis përdoruesve të resurseve peshkore, dhe midis tyre dhe përdoruesve të tjerë të zonës bregdetare.

10.1.5 Shtetet duhet të nxisin krijimin e procedurave dhe mekanizmave, në nivelin përkatës administrativ, për të zgjidhur konfliktet që lindin brenda sektorit të peshkimit dhe midis përdoruesve të resurseve peshkore dhe përdoruesve të tjerë të zonës bregdetare.

10.2 Masat politike

10.2.1 Shtetet duhet të nxisin krijimin e ndergjegjesimit publik të nevojës për mbrojtjen dhe menaxhimin e resurseve bregdetare dhe pjesëmarrjen në procesin e menaxhimit të gjithë të interesuarve për këto probleme.

10.2.2 Me qëllim për të ndihmuar marrjen e vendimeve në ndarjen dhe përdorimin e resurseve bregdetare, Shtetet duhet të bëjnë vlerësimin e vlerës përkatëse të tyre, duke marrë parasysh faktorët ekonomikë, socialë dhe kulturorë.

10.2.3 Në përcaktimin e politikave për menaxhimin e zonave bregdetare, Shtetet duhet të llogarisin mirë rreziqet dhe pasiguritë që ndeshen në menaxhimin e këtyre zonave.

10.2.4 Shtetet, në përputhje me mundësitë e tyre, duhet të krijojnë ose të nxisin krijimin e sistemeve për monitorimin e mjedisit bregdetar, si pjesë e procesit menaxhues bregdetar duke përdorur parametra fizike, kimike, biologjike, ekonomike dhe shoqërore.

10.2.5 Shtetet duhet të nxisin kërkimin shkencor në shumë disiplina në mbështetje të menaxhimit të zonave bregdetare, në veçanti mbi aspektet mjedisore, biologjike, ekonomike, shoqërore, ligjore dhe institucionale.

10.3 Bashkëpunimi rajonal

10.3.1 Shtetet me zona bregdetare fqinje, duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të lehtësuar përdorimin e qëndrueshëm të resurseve bregdetare dhe ruajtjen e mjedisit.

10.3.2 Në rastin e aktiviteteve që mund të kenë një efekt mjedisor nderkufitar negativ mbi zonat bregdetare, Shtetet duhet:

a) të sigurojnë në kohën e duhur informacione, dhe nëse është e mundur, njoftim paraprak të Shteteve të prekura nga këto efekte;

b) të konsultohet me këto Shtete sa më shpejtë të jetë e mundur.

10.3.3 Shtetet duhet të koepërojnë në nivel nënrajonal dhe rajonal me qëllim për të përmirësuar menaxhimin e zonave bregdetare.

10.4 Zbatimi

10.4.1 Shtetet duhet të krijojnë mekanizma për bashkëpunim dhe koordinim midis autoriteteve kombëtare të përfshirë në planifikimin, zhvillimin, ruajtjen dhe menaxhimin e zonave bregdetare.

10.4.2 Shtetet duhet të sigurojnë që autoriteti ose autoritetet që përfaqësojnë sektorin e peshkimit në procesin e menaxhimit bregdetar, të kenë kapacitetet teknike dhe burimet financiare të duhura.

NENI 11- PRAKTIKAT PAS ZENIES SE PESHKUT DHE TREGTIA

11.1 Perdorimi i pergjegjshem i peshkut

11.1.1 Shtetet duhet te marrin masa perkatese per te siguruar te drejten e konsumatoreve per peshk dhe produkte te peshkimit te sigurta, te shendetshme dhe cilesore.

11.1.2 Shtetet duhet te krijojne dhe te mirembajne sisteme efektiv asikuracioni kombetare sigurie dhe cilesie, per mbrojtjen e shendetit te konsumatorit dhe parandalimin e mashtrimin tregetar.

11.1.3 Shtetet duhet te vendosin standarde minimale per asikuracione te sigurise dhe te cilesise dhe te jene te sigurt qe keto standarde te aplikohen efektivisht ne te gjithe industrine. Ata duhet te nxisin zbatimin e standardeve te cilesise te pranuar brenda kontekstit te FAO-s /WHO Codex Alimentarius Commission dhe organizmave ose marreveshjeve qe kane lidhje me to.

11.1.4 Shtetet duhet te bashkepunojne per te arritur harmonizimin, ose njohjen reciproke, ose te dyja se bashku, te masave kombetare sanitare dhe te programeve certifikuese, siç eshte e pershtatshme, dhe te gjejne mundesite per realizimin e kontroleve dhe veprimeve certifikuese te pranuar reciprokisht.

11.1.5 Shtetet duhet te japin rendesine e duhur rolit ekonomik dhe shoqeror te sektorit te pas-zenies te peshkimit, kur te formulojne politikat kombetare per zhvillimin dhe perdorimin e qendrushem te resurseve peshkore.

11.1.6 Shtetet dhe organizmat perkates duhet te sponsorizojne kerkimet ne teknologjine dhe sigurimin e cilesise e peshkut dhe te mbeshtesin projekte ne lidhje me permiresimin e trajtimit pas zenies se peshkut, duke marre parasysh pasojat (impaktet) ekonomike, shoqerore, mjedisore dhe ushqimore te projekteve te tilla.

11.1.7 Shtetet, duke pare ekzistencen e metodave te ndryshme te prodhimit, duhet nepermjet bashkepunimit dhe lehtesimit te zhvillimit dhe transferimit te teknologjive te pershtatshme, te sigurojne qe metodat e perpunimit, transportit dhe grumbullimit te respektojne edhe anen mjedisore.

11.1.8 Shtetet duhet te inkurajojne ata qe merren me perpunimin, shperndarjen dhe marketingun e peshkut per te:

- a) reduktuar humbjet dhe mbeturinat mbas zenies se peshkut;
- b) permiresuar perdorimin e peshkut te zene aksidentalisht (by-catch) sa te jete e mundur, ne perputhje me praktikat menaxhuese te peshkimit te pergjegjshem; dhe
- c) perdorur resurset, vecanerisht ujin dhe energjine, ne vecanti drurin, ne respekt te mjedisit.

11.1.9 Shtetet duhet te inkurajojne perdorimin e peshkut per konsumim njerezor dhe te nxisin konsumimin e tij ku te jete e pershtatshme.

11.1.10 Shtetet duhet të bashkëpunojnë për lehtësuar prodhimin e produkteve me vlerë shtese nga vendet në zhvillim.

11.1.11 Shtetet duhet të sigurojnë që tregëtia ndërkombetare dhe e brendshme e peshkut dhe prodhimeve të peshkimit, të përputhet me praktikën e drejtë ruajtese dhe menaxhuese nëpërmjet përmirësimit të identifikimit të origjinës së peshkut dhe produkteve të tregtuara të peshkimit.

11.1.12 Shtetet duhet të sigurojnë që efektet mjedisore të aktiviteteve pas zënies së peshkut të jenë marrë në konsideratë në zhvillimin e ligjeve, rregulloreve dhe politikave që lidhen me to, pa krijuar çrregullime të tregut.

11.2 Tregtia përgjegjëshme ndërkombëtare

11.2.1 Nenet e këtij Kodi duhen interpretuar dhe zbatuar në përputhje me parimet, të drejtat dhe detyrimet të përcaktuara në Marrëveshjen e Organizatës Botërore të Tregtisë (WTO).

11.2.2 Tregtia ndërkombetare e peshkut dhe produkteve të tij, nuk duhet të komprometojë zhvillimin e qëndrueshëm të peshkimit dhe përdorimin e përgjegjshëm të resurseve ujore të gjalla.

11.2.3 Shtetet duhet të sigurojnë që masat që ndikojnë tregtine ndërkombetare të peshkut dhe produkteve të peshkimit, të jenë transparente, të bazuara, kur janë të mundura, mbi një evidence shkencore dhe të jenë në përputhje me rregullat ndërkombetare të pranuar.

11.2.4 Masat për tregtine e peshkut të përcaktuara nga Shtetet për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e njerëzve apo të kafshëve, interesat e konsumatorëve ose mjedisin, nuk duhet të jenë diskriminuese dhe duhet të jenë në përputhje me rregullat ndërkombetare tregtare të pranuar, në vecanti parimet, të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në Marrëveshjen për Zbatimin e Masave Sanitare dhe Fitosanitare dhe në Marrëveshjen mbi Barrierat Teknike për Tregtine të WTO.

11.2.5 Shtetet duhet të liberalizojnë me shumë tregtine e peshkut dhe produkteve të peshkimit, duke eliminuar barrierat dhe shtremberimet e tregtisë të tilla si taksat doganale, kuota e barrierat jo doganore, në konformitet me parimet, të drejtat dhe detyrat të përcaktuara nga Marrëveshja e Organizatës Botërore të Tregtisë (WTO).

11.2.6 Shtetet nuk duhet të krijojnë, direkt ose indirekt, pengesa të panevojshme apo të fshehta tregtimit, të tilla që kufizojnë lirinë e konsumatorit për zgjedhjen e furnizuesit, ose për të reduktuar hyrjen në treg.

11.2.7 Shtetet nuk duhet të kushtëzojnë mundësinë e tregut në futjen e resurseve. Ky parim nuk përjashton mundësinë e marrëveshjeve të peshkimit midis Shteteve që përfshijnë dispozita relative për përdorimin e resurseve, në tregtimin dhe futjen në treg, në transferimin e teknologjive, në kerkimin shkencor në trajnim dhe elemente të tjera.

11.2.8 Shtetet nuk duhet ta lidhin futjen në merkato me blerjen e teknologjive specifike ose me shitjen e produkteve të tjera.

11.2.9 Shtetet, ne lidhje me rregullat e tregtise se specieve te rrezikuara, duhet te bashkepunojme ne perputhje me marveshjet nderkombetare te cilat rregullojne kete problem.

11.2.10 Shtetet duhet te zhvillojne marveshje nderkombetare per tregtimin e eksemplareve te gjalle ku ekziston rreziku i demeve mjedisore nga Shtetet eksportuese dhe importuese.

11.2.11 Shtetet duhet te bashkepunojne per te nxitur aderimin dhe zbatimin efektiv te standarteve perkatese nderkombetare per tregtine e peshkut dhe produkteve te peshkimit dhe per ruajtjen e resurseve ujore te gjalla.

11.2.12 Shtetet nuk duhet te shkelin masat ruajtese te resurseve ujore te gjalla me qellim fitimi ne tregti ose ne investime.

11.2.13 Shtetet duhet te bashkepunojne per te zhvilluar standarte dhe rregulla nderkombetarisht te pranueshme per tregtine e peshkut dhe produkteve te peshkimit ne perputhje me parimet, te drejtat dhe detyrimet te percaktuara ne Marreveshjen e Organizates Boterore te Tregtise (WTO).

11.2.14 Shtetet duhet bashkepunojne ndermjet tyre dhe te marrin pjese ne menyre aktive ne forumet perkatese rajonale dhe shumepaleshe, si WTO, me qellim qe te sigurojne nje tregti equo (te barabarte) dhe jo diskriminuese te peshkut dhe produkteve te peshkimit dhe aderimin ne masat ruajtese shumepaleshe te pranuar te peshkimit.

11.2.15 Shtetet, organizmat qeveritare ndihmes, banka te zhvillimit shumepalesh dhe organizmat e tjere perkatese nderkombetare duhet te sigurojne qe praktikat dhe politikat e tyre ne lidhje me nxitjen e tregtise nderkombetare te peshkut dhe prodhimit per eksport mos te krijojne degradime mjedisore ose impakte negative mbi te drejtat dhe nevojat ushqimore te popullates per te cilat nga pikepamja e jeteses dhe mireqenjes peshku eshte jetik, si dhe per te tjeret qe nuk kane ose nuk mund ti perdorin keto resurse.

11.3 Ligjet dhe rregulloret në lidhje me tregtinë e peshkut

11.3.1 Ligjet, rregulloret dhe procedurat administrative te zbatueshme ne tregtine nderkombetare te peshkut dhe produkteve te peshkimit duhet te jene transparente, mundesisht sa me te thjeshta, te kuptueshme, dhe ku eshte rasti, te bazuara ne evidenca shkencore.

11.3.2 Shtetet, ne perputhje me ligjet e tyre kombetare, duhet te lehtesojne konsultimet adeguate dhe pjesemarrjen e industrise, te grupeve ambientaliste dhe konsumatoreve ne zhvillimin dhe zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve per tregtine e peshkut dhe produkteve te peshkimit.

11.3.3 Shtetet duhet te thjeshtezojne ligjet, rregulloret dhe procedurat administrative e tyre te zbatueshme per tregtine e peshkut dhe produkteve te peshkimit, pa vene ne rrezik efektivitetin e tyre.

11.3.4 Kur nje Shtet paraqet ndryshime ne kerkesat ligjore ne lidhje me tregtine e peshkut dhe produkteve te peshkimit me Shtetet te tjera, duhet dhene kohe dhe informacion i mjaftueshem per te

lejuar Shteteve dhe prodhuesve te interesuar te paraqesin, sic duhet, ne proceset dhe dhe procedurat e tyre ndryshimet e nevojshme.

11.3.5 Shtete ne menyre periodike duhe te rishqyrtojne ligjet dhe rregulloret e zbatueshme per tregetine e peshkut dhe produkteve te peshkimit, me qellim qe te percaktojne ne se ekzistojne akoma kushtet qe ishin ne baze te paraqitjes se tyre.

11.3.6 Shtetet duhet te harmonizojne, sa te jete e mundur, standartet e zbatueshme te tregetise nderkombetare te peshkut dhe produkteve te peshkimit ne perputhje me klauzolat perkatese e pranuar nderkombetare.

11.3.7 Shtetet duhet te mbledhin, te shperndajne dhe te shkembejne ne kohe, informacione statistike te sakta mbi tregetine e peshkut dhe produkteve te peshkimit nepermjet institucioneve kombetare dhe organizmave nderkombetare perkates.

11.3.8 Shtete duhet ne menyre te menjehershme te njoftojne Shtetet e interesuara, Organizaten Boterore te Tregtise (WTO), dhe organizmat e tjere perkates nderkombetare ne lidhje me zhvillimin dhe ndryshimet per ligjet, rregulloret dhe procedurat administrative te zbatueshme per tregetine nderkombetare te peshkut dhe produkteve te peshkimit.

NENI 12 KERMIMI SHKENCOR I PESHKIMIT

12.1 Shtete duhet te pranojne qe peshkimi i pergjegjeshem kerkon gatishmerine e nje baze solide shkencore per te asistuar menaxheret e peshkimit dhe palet e tjera te interesuara ne marrjen e vendimeve. Megjithate, Shtetet duhet te sigurojne qe te realizohen kerkime adeguate shkencore ne te gjitha aspektet e peshkimit duke perfshire biologjine, ekologjine, teknologjine, shkencat mjedisore, ekonomike, shkencat shoqerore, akuakulture dhe shkenca ushqimore. Shtetet duhet te sigurojne gatishmerine e strukturave te kerkimit shkencor dhe te realizojne formime (training) adeguate dhe struktura profesionale dhe institucionale per te drejtuar kerkimin shkencor, duke marre parasysh nevojat e vecanta te vendeve ne zhvillim.

12.2 Shtetet duhet te krijojne nje strukture institucionale adeguate per te percaktuar kerkime te aplikuar te kerkuara dhe perdorimet e e nevojshme te tyre.

12.3 Shtetet duhet te garantojne qe te dhenat nga kerkimet shkencore te analizohen, dhe rezultatet e ketyre analizave te publikohen, duke respektuar sekretin atu ku duhet, dhe te shperndahen ne kohe e ne menyre te kuptueshme paleve te interesuara, me qellim qe evidenca me e mire shkencore te jete e disponueshme si kontribut ne ruajtjen, menaxhemin dhe zhvilimin e peshkimit. Ne mungese te informacionit te duhur shkencor, kerkime shkencore adeguate duhen filluar sa me shpejte te jete e mundur.

12.4 Shtetet duhet te mbledhin te dhena te besueshme e te sakta, te nevojshme per vlersimin e gjendjes se ekosistemeve dhe resurseve iktike, perfshire te dhenat nga peshkimi aksidental, hedhjet e peshkut te paperdorshem (discards) dhe mbeturinat. Ku eshte e pershtatshme, keto te dhena duhet ti dergohen Shteteve te interesuara dhe organizmave te peshkimit nenrajonal, rajonal dhe global, ne kohen dhe ne nivelin e perpunimit te duhur.

12.5 Shtetet duhet te jene te afta te monitorojne dhe vleresojne gjendjen e rezervave (stocks) ne juridiksionin e tyre, duke perfshire impaktet e ndryshimeve te ekosistemeve si pasoja te presionit te peshkimit, ndotjes dhe alternimit te habitateve. Ata gjithashtu duhet te krijojne kapacitetin e nevojshem te kerkimit shkencor per vlersimin e efekteve te ndryshimit te klimes ose te mjedisit ne stocks iktik dhe ne ekosistemet ujore.

12.6 Shtetet duhet te mbeshtetin dhe te forcojne kapacitetin e kerkimit shkencor kombetar per arritjen e standarteve shkencore bashkekohore.

12.7 Shtetet, ne bashkepunim te nevojshem me organizmat perkates nderkombetare, duhet te inkurajojne kerkime shkencore per te siguruar perdorimin optimal te resurseve iktike dhe te stimuloje kerkimet e duhura ne mbeshtetje te politikave kombetare ne lidhje me peshkun si ushqim.

12.8 Shtetet duhet te drejtojne dhe te monitorojne kerkimet ne drejtim te ushqimeve njerezore me prejardhje nga resurset ujore dhe mjediseve nga merren keto ushqime e te sigurojne qe te mos te kete pasoja (impakt) negativ mbi konsumatorin. Rezultatet e ketyre kerkimeve duhet te jene publikisht te disponueshme.

12.9 Shtetet duhet te garantojne qe aspektet ekonomike, sociale, te merkatit dhe institucionale te peshkimit te studjohen ne menyre te rregullt dhe te dhenat te jene te vlefshme per monitorimin, analizen dhe me formulimin e politikave edhe ne vazhdim.

12.10 Shtetet duhet te kryejne studime mbi selektivitetin e mjeteve te peshkimit, impaktin mjedisor te mjeteve te peshkimit mbi speciet target dhe sjelljen e specieve target dhe non target ne lidhje me keto mjete peshkimi, me qellim qe te ndihmohen vendimet menaxhuese dhe te zvogelohen zenjet e panevojshme, si dhe te ruhet biodiversiteti i ekosistemeve dhe habitateve ujore.

12.11 Shtete duhet te garantojne qe, para futjes ne perdorim te mjeteve te reja, te behet nje vlersim shkencor i ndikimit te tyre mbi peshkimin dhe ekosistemin ku perdoren. Efektet e futjes ne pune te ketyre mjeteve duhen monitoruar.

12.12 Shtete duhet te studjojne dhe dokumentojne njohurite dhe teknologjite tradicionale, ne vecanti ato te aplikuar ne peshkimin ne shkalle te vogel, me qellim te vlersojne aplikimin e tyre ne lidhje me ruajtjen, menaxhimin dhe zhvillimin e pergjegjeshem te peshkimit.

12.13 Shtetet duhet te nxisin perdorimin e rezultateve te kerkimeve si baze per te percaktuar objektivat, pikat te referimit dhe kriteret te ekzekutimit, si dhe per te garantuar lidhjet e duhura ndermjet kerkimeve shkencore te aplikuar dhe menaxhimit te peshkimit.

12.14 Shtetet qe kryejne aktivitete te kerkimit shkencor ne ujrat nen juridiksionin e nje Shteti tjeter, duhet te garantojne qe anijet e tyre te respektojne ligjet dhe rregulloret e ketij Shteti dhe ligjin nderkombetar.

12.15 Shtete duhet te nxisin pregatitjen e udhезuesve uniforme ne lidhje me kerkimin shkencor te peshkimit ne det te hapur (ujrat nderkombetare).

12.16 Shtetet duhet, ku eshte e pershtatshme, te mbeshtetin krijimin e mekanizmave, duke perfshire, ndermjet te tjerave, berjen e udhezuesve uniform, per te lehtesuar kerkimin shkencor ne nivel nenrajonal e rajonal dhe duhet te inkurajojne shkembimin e rezultateve te ketyre kerkimeve me rajonet e tjera.

12.17 Shtetet, si direkt ashtu edhe me mbeshtetjen e organizmave nderkombetare perkates, duhet te zhvillojne programe te kerkimit shkencor dhe bashkepunimit teknik per te permiresuar te kuptuarit te biologjise, mjedisit dhe gjendjes se rezervave (stocks) ujore nderkufitare.

12.18 Shtetet dhe organizmat nderkombetare perkates duhet te nxisin dhe te permiresojne kapacitetin e kerkimit shkencor te vendeve ne zhvillim, ndermjet te tjerave, ne lidhje me mbledhjen dhe analizen e te dhenave, informacionin, shkencen dhe teknologjine, zhvillimin i resurseve njerezore dhe pajisjen e strukturave te kerkimit shkencor, me qellim per ti lejuar ato te marrin pjese ne menyre efektive ne ruajtjen, menaxhimin dhe perdorimin e qendrueshem te resurseve ujore te gjalla.

12.19 Organizmat nderkombetare kompetent duhet, ku eshte e pershtatshme, te japin mbeshtetje teknike dhe financiare Shteteve qe e kerkojne kete mbeshtetje, dhe kur te jene angazhuar ne studime kerkimore shkencore ne lidhje me stocks qe nuk jane peshkuar ose qe jane peshkuar pak.

12.20 Organizmat perkatese nderkombetare teknik dhe financiar duhet, mbas kerkeses se Shteteve, te mbeshtetin Shtetet ne perpjekjet e tyre ne kerkimin shkencor, duke i dhene vemendje te vecante vendeve ne zhvillim, ne veçanti me pak te zhvilluarit ndermjet tyre dhe ishujt e vegjel te vendeve ne zhvillim.

Aneks 1

PERMBLEDHJE RRETH ORIGJINËS DHE PERPUNIMIT TË KODIT

Ky aneks pershkruan procesin e perpunimit dhe negocimit te Kodit, e cila u shoqerua me paraqitjen per aprovim ne Sesionin e XXIII te Konferences se FAO-s. U pa e dobishme te baskengjitej ku aneks si referim origjines dhe zhvillimit te kodit dhe ne kete menyre te reflektoheshin interesat e lindura dhe fryma e kompromisit e te gjitha paleve te perfshire ne perpunimin te tij. Shpresojme qe ky do te kontriboje ne nxitjen e angazhimit te nevojshem per zbatimin e tij.

Ne forume te ndryshme nderkombetare, per nje kohe te gjate eshte shprehur shqetesimi ne lidhje me shenjat e qarta te mbishfrytezimit te stocks te rendesishme te peshkut, te demtimit te ekosistemeve, humbjeve ekonomike, problemeve ne lidhje me tregesine e peshkut dhe te gjitha keto kercenojne qendrushmerine afatgjate te peshkimit dhe keshtu demtojne kontributin e peshkimit ne furnizimin ushqimor. Ne diskutimet mbi gjendjen aktuale dhe perspektivat e peshkimit ne bote ne sesionin e 19-te te Komitetit te Peshkimit (COFI) te FAO-s, mbajtur me 19 Mars 1991, u rekomandua qe FAO duhet te zhvilloje konceptin e peshkimit te pergjegjeshem dhe duhe te perpunojte nje Kod te Drejtimit per kete qellim.

Me pas, Qeveria e Meksikes ne bashkepunim me FAO-n, organizoi ne Cancun, Maj 1992, Konferencen Nderkombetare te Peshkimit te Pergjegjeshem. Ne Deklaraten e Cancun te kesaj konference u pranua te zhvillohej me tej koncepti i peshkimit te pergjegjeshem, duke cituar qe "ky koncept permbledh perdorimin e qendrushem te resurseve te peshkimit ne harmoni me mjedisin; menytrat e zenjes dhe praktika te akuakultures te cilat nuk demtojne ekosistemet, resurset ose cilesite e tyre; futjen e vleres shtese te ketyre produkteve nepermjet proçeseve te transformimit duke plotesuar standartet sanitare; drejtimin e praktikave tregtare ne menyre qe konsumatori te perdore produkte te cilesise se mire".

Deklarata e Cancun ishte ne qender te vemendjes te Summit te UNCED Rio, mbajtur ne Qershor 1992, i cili mbeshteti pregatitjen per nje Kodi te Drejtimit per Peshkim te Pergjegjeshem. Konsultimi Teknik i FAO-s per Peshkimin ne Det te Hapur, mbajtur ne Shtator 1992, rekomandoi me tej perpunimin e nje Kodi ne drejtim te problemeve te peshkimit ne det te hapur (ujrat nderkombetare).

Ne sesionin e 102 te Keshillit te FAO-s, mbajtur ne Nentor 1992, u diskutua perpunimi i Kodit, duke rekomanduar qe prioritet duhet dhene problemeve ne lidhje me detin e hapur dhe u kerkua qe propozimet per Kodin te paraqiten ne sesionin e vitit 1993 te Komitetit te Peshkimit.

Ne sesionin e 20 te Komitetit te Peshkimit, mbajtur ne Mars te 1993, u shqyrtuan parimet e pergjithshme te ketij Kodi, duke perfshire perpunimin e udhezuesve dhe u pranua programi perpunimit te metejshem i Kodit. Gjithashtu ju kerkua FAO-s te pregatiste, sa me shpejt, si pjese te Kodit, propozime per te parandaluar zevendesimet e flamureve te anijeve te peshkimit te cilat ndikojne ndikojne ne masat ruajtese dhe menaxhuese ne ujrat ne det te hapur.

Zhvillimi i metejshem i Kodit të Drejtimit për Peshkim të Pergjegjeshem është realizuar në akord me konsultimet dhe bashkëpunimet e Organizmave të Kombeve të Bashkuara dhe organizmat e tjere ndërkombetare duke përfshirë organizmat jo-qeveritare.

Në zbatim të udhëzimeve të Organeve Drejtuese të FAO-s, drafti i Kodit u formulua në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara për Ligjin e Detit (the United Nations Convention on the Law of the Sea), duke marrë parasysh Deklaratën e Cancun të 1992, Deklaratën e Rio të 1992, klauzolat e Agjendës 21 të UNCED, konkluzionet dhe rekomandimet e Konsultimit Teknik të FAO-s për Peshkimin në Det të Hapur të vitit 1992, Strategjia e pranuar nga Konferenca Botërore e FAO 1984 për Zhvillimin dhe Menaxhimin e Peshkimit, dhe dokumenta të tjere perkates duke përfshirë perfundimet e Konferencës së Kombeve të Bashkuara straddling stocks dhe stocks e peshkut të migratoreve tipike (United Nations Conference on Straddling Fish Stocks and Highly Migratory Fish Stocks) e cila në Gusht të 1995 aprovoi Marrëveshjen për Zbatimin e Dispozitave të Konventës së Kombeve të Bashkuara të Ligjit për Detin të 10 Dhjetorit të 1982 në lidhje me straddling stocks dhe stocks e peshkut të migratoreve tipike.

Konferenca e FAO-s, në sesionin e 23 në Nentor të 1993, aprovoi Marrëveshja për Nxitjen e Respektimit të Masave Nderkombetare në Ruajtjen dhe Menaxhimin nga Anijet e Peshkimit në Det të Hapur (Agreement to Promote Compliance with International Conservation and Management Measures by Fishing Vessels on the High Seas) dhe rekomandoi që Parimet e Pergjithshme të Kodit të Drejtimit për Peshkim të Pergjegjeshem të përgatiten në mënyrë të shpejte e të pershtatshme, me qëllim që të vazhdohet me nënet tematike. Në këto mënyrë, teksti i draftit të Parimeve të Pergjithshme u rishikua nga një Grup Pune jozyrtar i ekspertëve të caktuar nga shtetet, të cilët u takuan në Romë në Shkurt të 1994. Drafti i rishikuar ju shpernda të gjithë Anëtarëve të FAO-s dhe Anëtarëve asociati, si dhe organizmave ndërqeveritare dhe joqeveritare. Komentet e arritura në versionin e dytë të Parimeve të Pergjithshme u përfshinë në draftin e Kodit së bashku me propozime për tekste alternative. Gjithashtu ky dokument ju nënshtrua dhe konsultimeve jozyrtare të organizmave joqeveritare në rastin e Sesionit të Katërt të Konferencës së Kombeve të Bashkuara për straddling stocks dhe stocks e peshkut të migratoreve tipike, mbajtur në New York në Gusht të 1994.

Me qëllim të lehtësoje gjykimin për tekstin e plotë të draftit të Kodit, Drejtori i Pergjithshëm propozoi në Sesionin e 106 të Këshillit të FAO në Qershor të 1994, të organizohej një Konsultim Teknik për Kodin e Drejtimit për Peshkim të Pergjegjeshem, me pjesëmarrjen e të gjithë Anëtarëve të FAO-s, jo anëtarëve të interesuar, si dhe organizmave ndërqeveritare dhe joqeveritare, me qëllim të jepet rasti të gjitha paleve të interesuara të marrin pjesë në përpunimin e Kodit.

Ky Konsultim Teknik u zhvillua në Romë nga 26 Shtatori deri më 5 Tetor 1994 dhe u prezantua drafti i plotë i Kodit dhe drafti i parë i udhëzuesve teknike në mbështetje të nëneve tematike të Kodit. Mbas analizimit të terësor të të gjithë Neneve të draftit të Kodit të Drejtimit, një draft alternativ I Sekretariatit u përgatit në bazë të komenteve të bera gjatë diskutimeve dhe propozimeve të paraqitura me shkrim gjatë Konsultimit.

Konsultimi analizoi gjithashtu në detaje një draft alternativ për tre nga gjashtë Nenet tematike të kodit, nëni 9 “Integrimi i Peshkimit në Menaxhimin e Zonës Bregdetare“, nëni 6 “Menaxhimi i

Peshkimit“, neni 7 “Aktivitetet e Peshkimit“, perjashtuar ato nene te cilat mund te influencohen nga perfundimet e Konferences ne vazhdim se Kombeve te Bashkuara. Nje Raport Administrativ i shkurtër u pregatit dhe ju paraqit Keshillit te FAO-s dhe Komitetit te Peshkimit.

Konsultim Teknik propozoi Keshillit ne sesionin 107, 15 – 24 Nentor 1994, qe formulimi perfundimtar i ketyre parimeve kryesisht ne lidhje me problemet ne det te hapur, te behet ne perfundim te rezultateve te Konferences se Kombeve te Bashkuara. Keshilli ne pergjithesi pranoi procedurat e propozuara, duke bere te ditur se diskutimet do te vazhdonin ne sesionin e ardhshem te Komitetit te Peshkimit, dhe nje draft perfundimtar do te paraqitej ne Keshillin e FAO-s ne Qershor te 1995 i cili dote vendoste per nevojen e nje Komiteti Teknik me qellim perpunimin e metejshem, ne se kerkohet, te klauzolave te detajuara te Kodit.

Bazuar ne komentet e rendesishme dhe sugjerimeve te detajuara te bera ne Konsultimin Teknik, Sekretariati perpunoi nje draft te rishikuar te Kodit te Drejtimit per Peshkim te Pergjegjeshem, i cili u paraqit ne sesionin e 21 te Komitetit te Peshkimit, 10 – 15 Mars 1995.

Komiteti i Peshkimit gjithashtu u informua qe Konferenca e Kombeve te Bashkuara pritej te konkludonte punimet e tij ne Gusht te 1995. U propozua qe parimet e lena pezull (nuk kishin formulimin perfundimtar) ne tekstin e draftit te Kodit, mund te ishin formuluar duke shprehur konceptet e pranuar te Konferences se Kombeve te Bashkuara dhe ne perpuhtje me mekanizmat te vendosura ne Komitet dhe ne Keshill, perpara paraqitjes se Kodit te perfunduar per aprovim ne sesionin e 28 te Konferences se FAO-s.

Komiteti u informua per hapat e ndermarre nga Sekretariati ne pregatitjen e draftit te Kodit te Drejtimit. Komiteti krijoi nje Grup Pune me qellim qe te rishqyrtoje tekstin e draftit te Kodit. Grupi i Punes, i cili u mblodh me 10 – 14 Mars 1995, beri nje rishqyrtim te detajuar te draftit te Kodit ne vazhdim te punes te realizuar nga Konsulta Teknike. Ai kompletoi dhe aprovoi tekstin e neneve 8 – 11. Ne mungese te kohes, Grupi i Punes i dha direktiva Sekretariatit ne lidhje me rishikimin e neneve 1 –5. Ata gjithashtu rekomanduan qe elementet e kerkimit shkencor dhe te bashkepunimit si dhe te akuakultures te perfshihen ne Nenin 5; Parimet e Pergjithshme te reflektojne problemet e zhvilluara ne Nenet Tematike te Kodit.

Komiteti mbeshteti propozimet e pranuar ne ne Sesionin e 107 te Keshillit ne lidhje me mekanizmat e finalizimit te Kodit. Formulimi perfundimtar i ketyre parimeve kryesisht ne lidhje me problemet per straddling stocks dhe stocks e peshkut te migratoreve tipike, te cilat perbenin vetem nje pjese te vogel te Kodit duhet te rishikoheshin nen driten e perfundimeve e Konferences se Kombeve te Bashkuara. Grupi gjithashtu rekomandoi qe sapo marreveshja te jete arritur ne parim, do te jete e nevojshme per te harmonizuar aspektet ligjore, teknike dhe idiomatike te Kodit, me qellim per te lehtesuar aprovimin final te tij.

Raporti i punes i Grupit te Punes ju paraqit Mbledhjes Ministeriale te Peshkimit, mbajtur 14 –15 Mars 1995, bashke me Sesionin e Komitetit te Peshkimit. Mareveshja e Romes per Peshkimin Boteror qe doli prej kesaj mbledhje kerkonte qe “Qeverite dhe organizmat nderkombetare te marrin veprime te menjehershme per te perfunduar Kodin Nderkombetar te Drejtimit per Peshkim te Pergjegjeshem ne lidhje me paraqitjen e tekstit perfundimtar ne Konferencen e FAO-s ne Tetor 1995”.

Ne Sesionin e 108 te Keshillit te FAO-s u paraqit versioni i rishikuar i kodit te Drejtimit. Keshilli krijoi nje Komitetit Teknik, sesioni i pare i te i cilit u zhvillua me 5-9 qershor 1995, me pjemarrjen e gjere te perfaqsesve rajonale, si anetare ashtu dhe vezhgues. Gjithashtu moren pjese nje numer organizmash nderqeveritare dhe joqeveritare.

Keshilli u informua nga Komiteti Teknik se ishin rishqyrtuar plotesisht nenet 1 –5, duke perfshire parathenjen. Gjithashtu ishin analizuar, korigjuar dhe aprovuar nenet 8-11. Keshilli gjithashtu u informua qe Komiteti kishte filluar rishikimin e nenit 6.

Keshilli miratoi pune e bere nga Komiteti Teknik dhe pranoi rekomandimet e tij per Sesionin e Dyte, 25-29 Shtator 1995, per te perfunduar rishikimin e Kodit sapo Sekretariati te kishte perpunuar tekstin nga pikpamja linguistike dhe juridike, duke marre parasysh perfundimet dhe orientimet e Konferences ne vazhdim se Kombeve te Bashkuar per straddling stocks dhe stocks e peshkut te migratoreve tipike.

Nje version i rishikuar i Kodit, i miratuar nga Komiteti Teknik ne sesionin e pare tetij (5-9 qershor 1995) dhe i pranuar nga Sesionin e 108 te Keshillit te FAO-s, u publikua si dokument Konference (C95/20) dhe dokument pune per Sesionin e Dyte te Komitetit Teknik. Elementet e pazgjidhur te marreveshjes ishin mire identifikuar.

Me qellim per te lehtesuar perfundimin e plote te Kodit, Sekretariati pregatiti dokumentin “Propozime te Sekretariatit per nenet 6, Menxhimi i Peshkimit, dhe 7, Aktivitete e Peshkimit, te Kodit te Drejtimit per Peshkim te Pergjegjeshem“, duke marre parasysh Mareveshjen ne lidhje me Ruajtjen dhe Menaxhimin per straddling stocks dhe stocks e peshkut te migratoreve tipike, e pranuar ne Konferencen e Kombeve te Bashkuara ne Gusht 1995. Sekretariati gjithashtu plotesoi propozimet per perpunimit e tekstit nga pikpamja linguistike dhe juridike dhe paraqiti Komitetit te perfunduar tekstin ne tre gjuhe (ingleze, franceze dhe spanjole).

Sesioni i Dyte i Komitetit Teknik i Keshillit u mbajt me 25-29 Shtator 1995 me pjemarrjen e gjere te rajoneve dhe organizmave te interesuara. Komiteti, duke punuar me nje fryme te larte bashkepunimi, ne menyre te sukseshme perfundoi mandatin e tij, duke finalizuar dhe miratuar te gjitha nenet dhe Kodin ne teresi. Komitetit Teknik pranoi qe negocimet ne lidhje me tekstin e Kodit ishin perfunduar. Nje Grup Pune jozyrtar per Pershtatjen Gjuhesore zhvilloi nje sesion shtese dhe se bashku me sekretariatit perfunduan harmonizimin gjuhesor te tekstit. Komitetit Teknik instrukttoi Sekretariatit per te perfunduar dhe per te paraqitur dokumentin e rishikuar ne Sesionin e 109 te Keshillit dhe ne Sesionin e 28 te konferences per miratimin e tij. Keshilli miratoi Kodin e Drejtimit sic e kishte perfunduar Komiteti Teknik. Sekretariatit ju kerkua per te pregatitur rezoluta draft e Konferences, duke perfshire nje kerkese vendeve per te pranuar, si nje problem urgjent, Marreveshjen e Respektit te pranuar ne sesionin e fundit te Konferences. Sesioni i 28 i Konferences miratoi me 31 Tetor 1996, me konsensus, Kodin e Drejtimit per Peshkim te Pergjegjeshem dhe Rezoluten perkatese te paraqitur ne Aneksin 2.

Aneks 2

REZOLUTE

KONFERENCA

Duke njohur rolin vital të peshkimit ne botë ne lidhje me sigurim e ushqimit, zhvillimin social dhe ekonomik si dhe nevojën për të siguruar qendrueshmëri të resurseve ujore të gjalla dhe mjediseve të tyre për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm,

Duke kujtuar që Komiteti i Peshkimit në 19 Mars 1991 rekomandoi zhvillimin e konceptit të peshkimit të përgjegjshëm dhe formulimin e mundshëm të një dokumenti në lidhje me të,

Duke marrë parasysh që Deklarata e Cancun, e cila u bë në Konferencën Nderkombëtare të Peshkimit të Përgjegjshëm në Maj 1992, organizuar nga qeveria e Meksikës në bashkëpunim me FAO-n, kërkoj përgatitjen e një Kodi të Drejtimit për Peshkim të Përgjegjshëm,

Duke sjellë ndër mend që me futjen në fuqi të Konventës së Kombeve të Bashkuara në Ligjin e Detit, 1982, dhe me miratimin e Marrëveshjes për zbatimin e klauzolave të Konventës së Kombeve të Bashkuara në Ligjin e Detit 1982 në lidhje me Ruajtjen dhe Menaxhimin e straddling stocks dhe stocks e peshkut të migratoreve tipike, siç u anticipua në 1992 në Deklaratën e Rio-s dhe në klauzolat e Agjendës 21 të UNCED, është rritur nevoja e bashkëpunimit nënrajonal dhe rajonal, dhe përgjegjësi të rëndësishme janë caktuar FAO-s në përputhje me mandatin e tij,

Duke kujtuar me tej që Konferenca në 1993 miratoi Marrëveshjen për Nxitjen e Respektimit të Masave Nderkombëtare në Ruajtjen dhe Menaxhimin nga Anijet e Peshkimit në Det të Hapur, dhe kjo Marrëveshje duhet të përfsihet si pjesë integrale e Kodi të Drejtimit,

Duke vërejtur me kënaqësi që FAO, në përputhje me vendimet e organeve drejtuese të tij, organizoi një radhë mbledhjesh teknike për të formuluar Kodin e Drejtimit, dhe këto takime rezultuan të sukseshme në përpunimin e tekstit të Kodi të Drejtimit për Peshkim të Përgjegjshëm,

Duke vlersuar që Konsensusi i Romës për Peshkimin në Bote, i cili u arrit në Takimin Ministerial të Peshkimit më 14-15 Mars 1995, kërkoj qeverive dhe organizmave ndërkombëtare për tu përgjigjur në mënyrë efektive për situatën aktuale të peshkimit, ndërmjet të tjerave, për të perfunduar Kodin e Drejtimit për Peshkim të Përgjegjshëm dhe për të marrë parasysh miratimin Marrëveshjen për Nxitjen e Respektimit të Masave Nderkombëtare në Ruajtjen dhe Menaxhimin nga Anijet e Peshkimit në Det të Hapur:

Vendosi të miratojë Kodin e Drejtimit për Peshkim të Përgjegjshëm;

Beri thirrje Shteteve, Organizmave Nderkombëtare, Qeveritare dhe Joqeveritare, dhe të gjithë atyre të përfshirë në peshkim të bashkëpunojnë në realizimin dhe zbatimin e objektivave dhe parimeve të Këtij Kodi;

Insistoi qe nevojat e vecanta te vendeve ne zhvillim te merren parasysh ne zbatimin e dispozitave te ketij Kodi;

Kerkoi FAO-s te merrte masat ne Programin e Punes dhe Buxhetit per asistence per vendet ne zhvillim ne zbatimin e Kodit dhe per perpunimin e nje Programi Asistence Nder-rajonale per asistence ne mbeshtetje te zbatimit te Kodit;

Kerkoi me tej FAO-s, ne bashkepunim me anetaret dhe organizmat perkates te interesuara, te perpunonte udhezues teknik ne mbeshtetje te zbatimit te kodit;

Fton (ben apel, thirrje) FAO-n te monitoroje dhe te raportoje ne lidhje me zbatimin e Kodit dhe efekteve te tij ne peshkim, duke perfshire veprimet e ndermarra ne zbatim te dokumentave dhe rezolutave te tjere te organizmave te Kombeve te bashkuara dhe ne vecanti te rezolutave te miratuara nga Asambleja e Pergjithshme per te bere efektive Konferencen per stocks e peshkut te mbivendosura e stocks e peshkut te migratoreve te shume te shpejte duke arritu ne Marreveshjen per zbatimin e klauzolave te Konventes se Kombeve te Bashkuara ne Ligjin e Detit 1982 ne lidhje me Ruajtjen dhe Menaxhimin e stocks e peshkut te mbivendosura e stocks e peshkut te migratoreve te shume te shpejte;

Rekomandoi FAO-s te forcoje Organet rajonale te Peshkimit me qellim qe te merren me efektivisht me problemet e ruajtjes dhe menaxhimit te peshkimit dhe ne mbeshtetje te bashkepunimit dhe koordinimit te peshkimit ne nivel nenrajonal, rajonal dhe global.